

# Strategjia

Kombëtare

për përmirësimin e kushteve të  
jetesës së minoritetit *Rom*

OSCE

Ky botim është financuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

# **Strategjia Kombëtare**

“Për përmirësimin e kushteve të jetesës  
së **MINORITETIT ROM**”

ISBN 99927-972-9-0

Shtypi "PEGI"


## FJALA HYRËSE

*Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, shtetet e saj pjesëmarrëse dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e konsiderojnë gjendjen e minoritetit rom një çështje shqetësuese për vendin. Gjatë viteve të shkuara Prezenca ka zbatuar disa projekte për t'i ardhur në ndihmë përpjekjeve që ka bërë Shqipëria për të përmirësuar kushtet e jetesës së këtij komuniteti. Prezenca e OSBE-së ka qenë një nga organizatorët e tryezës së parë të rumbullakët për romët dhe çështjet e romëve në vend dhe ka luajtur rol këshillues gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom.*

*Zyra e Avokatit të Popullit, e cila kujdeset për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, beson se të drejtat e romëve duhen respektuar dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'u siguruar që qeveria do të plotësojë realisht standartet e kërkuara.*

*Prezenca dhe Avokati i Popullit kanë besimin se botimi i Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom është jo vetëm kontribut konkret, por edhe hap praktik dhe i nevojshëm drejt zbatimit të kësaj strategjie. Kështu, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore si dhe aktorët e tjerë të interesuar vendas apo ndërkombëtarë, do të kenë mundësi të studiojnë këtë dokument të rëndësishëm i cili siguron drejtimin e punës në të ardhmen. Ky botim do t'u shpërndahet të gjithë aktorëve të lartpërmendur në mënyrë që të njihen me përmbajtjen dhe me punën që duhet bërë për zbatimin e Strategjisë.*

*Prezenca dhe Avokati i Popullit ndajnë mendimin se organet e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha, si në drejtim të përqendrimit të punës ashtu edhe në caktimin e fondeve për të përmbushur detyrimet e parashikuara në Strategji. Gjendja e romëve në Shqipëri ka nevojë për përmirësime të thella në mënyrë që ky komunitet të jetojë me dinjitet në një shoqëri demokratike. Prezenca shpreh gatishmërinë e saj të ndihmojë qeverinë në përpjekjet drejt zbatimit të Strategjisë dhe u bën thirrje gjithë aktorëve të shoqërisë civile, sidomos OJF-ve romë, të luajnë një rol aktiv në këtë drejtim.*



Pavel Vacek  
Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri



Ermir Dobjani  
Avokati i Popullit

**VENDIM**  
**Nr. 633, datë 18.9.2003**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË  
MINORITETIT ROM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale,  
Këshilli i Ministrave

**VENDOSI**

1. Miratimin e strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

## **STRATEGJIA KOMBËTARE “PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË MINORITETIT ROM”**

Strategjia kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të minoritetit rom” është realizuar nga një grup ndërministror i drejtuar nga Zëvendësministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale z. Ahmet Ceni në përbërje të të cilit janë:

Gramoz Bregu	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Vasil Tole	Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve
Agim Shehi	Ministria e Shëndetsisë
Genta Qosja	Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
Anila Selmani	Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
Rezarta Bitri	Ministria e Drejtësisë
Shyqyri Dade	Ministria e Rendit Publik
Violeta Qebini	Ministria e Pushtetit Lokal dhe e Decentralizimit
Shqipe Rrumbullaku	Ministria e Ekonomisë dhe e Privatizimit
Doris Andoni	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit
Geraldina Duçka	Ministria e Financave
Agim Gjevori	Ministria e Transporteve
Brunilda Minarolli	Ministria e Punëve të jashtme

Koordinatorë e grupit ndërministror Merita Gjashta

Në hartimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të minoritetit rom” ka ndihmuar përfaqësuesi i organizatave romë në Grupin Ndërministror Refik Tare, si dhe OJF-të romë; Romët për Integrim, Amaro-Drom, Romani Batx, Shanci Rom, Amaro-Dives, Disutni Albania si dhe përfaqësuesit e këtyre organizatave, zotërinjtë Arben Kosturi, Hasan Sula, Miranda Fejzo, Sabri Mile, Estref Pëllumbi, Kujtim Gajtani, Latif Kazanxhi, Ilmi Ademi, Nesti Zeqiri, Xheladin Taço, Pëllumb Fortuna, Kujtim Shabani, Skënder Veliu, Muhamet Xhambazi, Gurali Mejdani, Ramazan Elmazi.

## Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Emri i plotë
MPÇS	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MRP	Ministria e Rendit Publik
MRTT	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
MEP	Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit
MF	Ministria e Financave
MJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPVD	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
KMB	Komiteti për Mundësi të Barabarta
SHKP	Sherbimi Kombëtar i Punësimit
ISHP	Inspektoriati Shtetëror i Punës
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
DSHP	Drejtorja e Shëndetit Publik
IshP	Instituti Shëndetit Publik
ANVM	Agjensia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
CIOFF	Organizatë ndërkombëtare kulturore e festivaleve folklorike
OQV	Organet e Qeverisjes Vendore
DA	Drejtorja Arsimore
DSH	Drejtoritë e Shkollave
IKP	Instituti i Kulturës Popullore

# HYRJE

## ***Pak histori***

**H**istorikisht popullsia shqiptare është karakterizuar nga marrëdhënie harmonike midis pakicave etnike dhe shumicës. Këto marrëdhënie kanë evoluar në shekuj duke e renditur Shqipërinë si vend model për bashkëjetesën midis komuniteteve etnike dhe besimeve fetare.

Minoriteti rom konsiderohet një minoritet gjuhësor. Të dhënat statistikore lidhur me numrin e romëve që jetojnë në Shqipëri, mungojnë, pasi një regjistrim i përgjithshëm i tyre nuk është bërë asnjëherë.

Romët jetojnë në Shqipëri për më tepër se 600 vjet. Ata kanë arritur në Shqipëri para pushtimit otoman. Nga studimet e bëra supozohet se kanë ardhur nga India pastaj nëpërmjet Ballkanit në Europë. Origjina e tyre njihet jo për shkak të dëshmive të sakta historike por kryesisht nga analizat gjuhësore. Në kohën e pushtimit otoman për arsye sigurie, romët kanë ndryshuar besimin e tyre fetar duke e konvertuar në besim mysliman, njëllor siç bëri një pjesë e mirë e popullsisë etnike shqiptare në atë kohë. Gjatë luftës së dytë botërore, romët e Shqipërisë nuk u përsekutuan në kampet e vdekjes siç ndodhi në shumë vende të Europës Lindore. Romët shqiptare kanë marrë pjesë në luftë dhe shumë prej tyre kanë luftuar së bashku me ushtrinë shqiptare kundra pushtuesve të huaj. Mbas luftës shteti shqiptar ndoqi politikën e asimilimit dhe të homogjenizimit të kombit shqiptar duke e konsideruar këtë komunitet si pjesë e popullsisë shqiptare. Vlen për t'u theksuar se gjatë regjimit komunist, romët kanë përfutur punësimin, reformën agrare mbi tokën, sigurinë për të nesërmen, shkollimin e detyruar, strehimin, etj., ç'ka bëri që ata të integrohen njëllor si gjithë popullsia maxhoritare, pavarësisht të metave të atij sistemi. Në përputhje me politikën e punësimit të plotë, shteti ishte i detyruar t'u siguronte punësimin si burrave ashtu edhe grave në funksion të nivelit të shkollimit dhe të aftësive të tyre profesionale. Me përmbysjen e komunizmit dhe me fillimin e ndryshimeve demokratike romët ishin të parët që humbën punësimin dhe shkuan me shpejtësi në fund të shoqërisë. Për shkak të mungesës së arsimit dhe të kualifikimit të nevojshëm pozicioni i tyre në shoqëri ndryshoi në mënyrë drastike. Si rezultat i varfërisë së krijuar, me një përjashtim të vogël, gjenerata e re e fëmijëve romë, për të qënë krahë punë për familjet e tyre, nuk është në gjendje të ndjekë shkollat. Fëmijët romë janë shndërruar në lypsa dhe viktime të trafiqeve të ndryshme dhe të prostitucionit. Aktualisht situata ekonomike e romëve të Shqipërisë dhe kushtet e jetesës janë në nivele shumë të ulëta për shkak të papunësisë që është në shifra disa herë më e madhe se pjesa tjetër e popullsisë jo rome. Kushtet e shëndetit dhe të strehimit janë shumë të këqija.

Për herë të parë romët u regjistruan në Shqipëri gjatë viteve 1522-23 dhe u vlerësuan rreth 1,270 vetë. Emri i romëve përmendet në tekste të vjetra shqiptare me 1635. Në vitin 1930 sipas vlerësimeve popullore kishte 20,000 romë në tërë vëndin. Në 1980 kishte 62,000 romë, të vlerësuar sipas dokumentave franceze. Kjo shifër u bazua në burime angleze. Më 1995 Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve vlerësoi se numëri i romëve ishte midis 90,000 dhe 100,000 vetë. Ndërsa Universiteti i Marylandit në 1995 deklaroi se ka deri në 120,000 romë që jetojnë në Shqipëri. Sot vlerësohet që ritmi i shtimit të popullsisë rome është 3% i cili paraqitet më i lartë se ai i shqiptarve. Pasaktësia e shifrave vjen nga fakti se asnjë regjistrim zyrtar në Shqipëri nuk i ka evidentuar romët.

Romët jetojnë pothuajse në të gjithë zonat e vendit. Megjithatë, numri më i madh i romëve është përqëndruar kryesisht në Shqipërinë Qendrore dhe Juglindore: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Pogradec, Bilisht, Gjirokastrë, Delvinë, Krujë, Shkodër etj. Romët jetojnë ose në qytetet e mëdha, kryesisht në lagje të ndara ose në fshatra pranë qyteteve. Nga të dhënat e përafërta që kemi mundur të sigurojmë rezulton:

Në Gjirokastrë, në zonën Zinzhiraj, numërohen rreth 1500 vetë. Shumica jeton në kushte shumë të varfëra, në shtëpi të përkohëshme, pa kushte sanitare dhe ujë të rrjedhshëm. Minoriteti rom përpiqet të emigrojë çdo verë për të punuar në Greqi nëpër ferma etj. Disa të tjerë importojnë veshje, këpuce dhe paisje elektrike të lira për t'i shitur në tregun e Gjirokastrës. Në këto kushte jeta e romëve të Gjirokastrës po veshitërohet edhe më shumë.

Lagjja Azotiku në Fier ka rreth 500 familje me një mesatare prej 8 fëmijësh sejlja. Ky komunitet jeton



paralel me linjën kryesore hekurudhore që kalon nëpër Fier. Meqë nuk ka rrugë që lidh vendbanimet me qytetin, ata detyrohen të përdorin rrugën hekurudhore në këmbë për nevojat me qytetin. Ky ka qënë shkaku kryesor i një numri fatkeqësish aksidentale. Ata vuajnë nga papunësia. Shumë pak fëmijë ndjekin shkollën me që ajo ndodhet shumë larg nga vendbanimet e tyre.

Në Levan Fier ka rreth 500 familje me një mesatare prej gjashtë personash. Shumica e fëmijëve këtu nuk shkojnë në shkollë dhe shumica e të rriturve janë të pa punë. Ata bëjnë një jetë mjaft të vështirë duke u përpjekur të mbijetojnë duke punuar tokën ose duke bërë enë metalike gatimi. Komuniteti këtu është i ndarë në dy grupe, ata që kanë tokë dhe ata që s'kanë.

Në Baltës ka rreth 250-300 familje me një mesatare prej 5 ose 6 vetash në secilën familje. Shumica e familjeve jeton në shtëpi të mira dhe kanë tokat e tyre. Ata gjithashtu kanë shkollën e tyre me cila i ndihmon për të mësuar gjuhën dhe kulturën rome.

Komuniteti në Kulleiri të Korçës ka rreth 600 familje. Në përgjithësi këtu komuniteti jeton njëllë si shqiptarët. Ata jetojnë në apartamente, kanë punësim dhe shumica e fëmijëve ndjekin shkollën.

Në Shkodër, komuniteti tek Ura e Bunës. Romët në Shkodër përbëhen prej 27 deri në 50 familje të cilët jetojnë në kushtet më të këqia në Shqipëri. Të gjithë shtëpitë e tyre janë prej tabakësh plastike dhe mungon uji i rrjedhshëm. Shumica e antarëve të këtij komuniteti detyrohen të pijnë ujë lumi mbasi nuk kanë burim tjetër. Papunësia këtu është 100%

Në Elbasan, komuniteti pranë Stadiumit. Ka një komunitet shumë të madh në Elbasan. Numëri i saktë i tyre nuk dihet. Një pjesë e tyre merret me shitjen e rrobave të vjetra.

Komuniteti rom në Fushë-Krujë. Romët e Fushë Krujës, afërsisht 1200 vetë, jetojnë në kushte tepër të vështira. Në përgjithësi i mungon strehimi, pijnë ujë lumi në mungesë të ujit të rrjedhshëm, papunësi e theksuar etj.

Në Berat, komuniteti tek Lagjja e Re. Komuniteti rom këtu është relativisht i vogël në numër, jo më tepër se 60 familje. Vendbanimet janë pranë lumit kryesor të Beratit. Komuniteti jeton në varfëri të theksuar meqënëse ato nuk kanë as tokë dhe as pasuri të tyre, madje nuk janë as të regjistruar tek autoritetet lokale për të marrë asistencë.

Megjithëse numëri i saktë nuk dihet, supozohet se numri më i madh i popullsisë rome është i përqëndruar në Tiranë. Vendbanimet e grupuara të tyre ndodhen kryesisht në Kinostudio, Laprakë, Bregu i Lumit, Selitë, Yzberisht etj. Problemet sociale të tyre janë të gjithanëshme. Evidente janë: papunësia, varfëria, braktisja e shkollave nga fëmijet dhe trafikimi i tyre, mungesë infrastrukture dhe strehimi, kushte shëndetësore të këqia etj. Një pjesë e romëve të Tiranës siguron mjetet e domosdoshme të jetesës duke gërmuar nëpër kazanët e plehrave apo duke lypur. Një numër i konsiderueshëm familjesh jetojnë në baraka të sajuara me mjete rrethore. Rreth 100 familje në Rrugën "Irfan Tomini" janë njoftuar nga Bashkia e Tiranës për t'u zhvendosur forcërisht për arsye të rregullimit urban.

PARIMET BAZË KU MBËSHTETET  
HARTIMI I STRATEGJISË

Pjesa e parë

---

## Shkaqet dhe domosdoshmeria e hartimit të strategjisë

---

Hartimi i strategjisë bazohet në analizën kritike dhe vlerësimin e problemeve të komunitetit rom, të cilat kanë të bëjnë me gjëndjen e tyre social-ekonomike.

Hartimi i Strategjisë është mbështetur në njohjen e situatës social-ekonomike dhe vlerësimin sasior e cilësor të nevojave të grupeve vulnerabël, në përpunimin e të dhënave statistikore të siguruara nga burime zyrtare dhe jozyrtare për shkallën e vulnerabilitetit dhe përjashtimit social, shpërndarjen dhe shpeshësinë e grupeve të rrezikuara. Të dhënat e siguruara nga këto burime edhe pse jo të plota, të pasakta dhe shpesh herë të paverifikuara nga burime të dyta, kanë shërbyer për njohjen e tendencave të zhvillimit social-ekonomik, identifikimin e dukurive të reja, dinamikës së ndryshimeve dhe ndikimet e tyre në kushtet e jetesës të këtij minoriteti.

Për hartimin e strategjisë së romëve janë shfrytëzuar analiza, studime, vëzhgime dhe raporte të realizuara nga institucione shtetërore dhe jo shtetërore, në disa zona si: Korçë, Fier, Novoselë, Vlorë, Berat, Fushë-Krujë, seminare, tryeza të rumbullakta, konferenca, simpoziume për sensibilizimin e kësaj kategorie në lidhje me mënyren e bashkëpunimit për realizimin me sukses të projekteve të përbashkëta me këtë komunitet.

Qeveria shqiptare duke parë vështirësitë me të cilat përballet popullsia rome në Shqipëri, angazhohet politikisht për hartimin e një strategjie për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakices rome që jeton në Shqipëri përmes politikave e programeve konkretë për zbutjen e varfërisë, përfshirjen e tyre në jetën publike, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre etnik, etj. Qeveria shqiptare shikon pakicën rome si një partner bashkëpunues në hartimin dhe zbatimin e këtij dokumenti të rëndësishëm.

---

## Baza ligjore

---

Në legjislacionin shqiptar një rëndësi të veçantë i është kushtuar njohjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si një nga shtyllat e shoqërisë së qytetëruar bashkëkohore. Kuadri ligjor për minoritetet në Republikën e Shqipërisë përfshin një numër të konsiderueshëm dispozitash ligjore të parashikuara në Kushtetutë, në Kodet Penale dhe të Proçedurës Penale, në aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe Konventat e Ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Shqipëria është anëtare e OKB-së që nga 14 Dhjetori 1955 dhe ka ratifikuar pothuajse të gjitha konventat kryesore të kësaj organizate lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, disa prej të cilave janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948 (aderuar më 1955); Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1969 (aderuar më 1994); Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966, (aderuar më 1991); Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1976, (aderuar më 1991); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980, (aderuar më 1996).

Shqipëria është anëtare e OSBE-së dhe ka nënshkruar të gjitha dokumentat e saj, si Akti Final i Konferencës së Helsinkit, 1975; Deklarata e Kopenhagenit, 1990; Karta e Parisit për një Evropë të re, 1990; Dokumenti i Konferencës së Moskës, 1991 etj.

Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës që nga 13 Korrik 1995 dhe ka nënshkruar dhe ratifikuar një numër të madh dokumentash të rëndësishme si Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1951; Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Në këtë këndvështrim mbrojtja e pakicave kombëtare trajtohet si nga ana e legjislacionit të brendshëm të shtetit shqiptar ashtu edhe nga regjimi i minoriteteve i përcaktuar në aktet ndërkombëtare.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Shteti shqiptar garanton kushte të barabarta trajtimi dhe në përgjithësi pakicat kanë të njëjtin nivel jetese si shumica. Minoriteti rom përballet me një situatë më të vështirë ekonomike dhe sociale, e cila karakterizohet nga një jetesë nën standartin e nivelit të jetesës, strehim jo të përshtatshëm dhe ofrimin e një mjedisi jo të përshtatshëm për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Megjithëse pakica rome nuk quhet pakicë kombëtare por pakicë gjuhësore, me argumentin se nuk ka një shtet referimi, parimet e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave

---

**Solidariteti social dhe barazia e racave, minoriteteve etj.**

---

Kombëtare aplikohen dhe për ta.

Vendi ynë gjithmonë është dalluar për një bashkëjetesë në harmoni dhe paqe midis pakicave kombëtare dhe besimeve fetare. Secila pakicë gjatë kësaj bashkëjetese në vite ka demonstruar orgjinalitetin e vet. Ky orgjinalitet është respektuar dhe sipas mundësive janë krijuar kushte për ruajtjen e vazhdimësisë së traditave nëpër breza.

Minoriteti rom ka një gjeografi pak a shumë të përcaktuar shpërndarjeje, por ka edhe difuzion në të gjithë popullsinë ç'ka shpreh edhe një herë pranimin dhe mirëkuptimin për të.

Minoriteti rom konsiderohet si pakicë gjuhësore dhe jo pakicë kombëtare, me argumentin se nuk ka një shtet të vetin. Megjithatë, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare është e aplikueshme dhe për këtë pakice.

---

**Partneriteti në evidentimin e përgjegjësive dhe të masave të marra për daljen nga situata**

---

Gjatë viteve të sistemit të kaluar, shteti zbatonte politika të trajtimit të barabartë duke integruar njëlloj të gjitha pakicat etnike.

Pas viteve 90, me ndryshimin e sistemit dhe ushtrimin e lirë të së drejtës së fjalës dhe organizimit, të gjitha pakicat u organizuan për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre në shoqëri.

Një rol të rëndësishëm për njohjen, zbulimin dhe zbutjen e problemeve sociale luajnë organizatat joqeveritare vendase dhe të huaja që indirekt janë ofrues të fuqishëm shërbimesh. Organizata të ndryshme kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke sensibilizuar opinionin për rrezikshmërinë e fenomeneve të tilla si trafikimi i fëmijëve, grave e vajzave, për qëllime të shfrytëzimit, shkeljen e të drejtave të qytetarëve romë nga institucione publike, persona juridikë e fizikë. Veprimtaria e organizatave të shoqërisë civile është e shumëllojshme, por shpesh herë ka qënë e pakoordinuar dhe jo e organizuar për të përdorur burimet e komunitetit në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës së vetë komunitetit. Organizatat rome kanë një mision human dhe fisnik për prezantimin me dinjitet të vlerave, elitës intelektuale rome, të lobimit dhe të përfshirjes në proceset vendimarrëse vendore dhe qendrore për çështje që lidhen me romët. Strategjia është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të qeverisë dhe përfaqësuesve të organizatave të komunitetit rom. Aplikimi i programeve dhe projekteve për implementimin e strategjisë ka nevojë për partneritet të vazhdueshëm. Përfaqësuesit e romëve duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha dhe të luajnë rolin e tyre për sensibilizimin e opinionit rom në drejtim të dukurive negative. Vëmëndje e veçantë i kushtohet atyre familjeve që me neglizhencën apo për qëllime shfrytëzimi, pengojnë zhvillimin e fëmijëve për edukimin e tyre, duke i kthyer në pre të trafikeve të ndryshme, të martesave të parakohëshme, të fenomeneve që vënë fëmijët në situata të vështira etj. Nga ana tjetër qeveria shqiptare duhet të mbështesë formimin dhe promovimin e një elite intelektuale dhe ekonomike brënda komunitetit rom, e cila do të lehtësojë aplikimin e integritit social dhe politikave modernizuese. Duhet të zhduken stereotipet, paragjykimet dhe praktikat që nëpunës të caktuar të institucioneve qendrore dhe lokale inkurajojnë diskriminimin e qytetarëve romë krahasuar me qytetarët e tjerë.

---

**Ruajtja dhe ransmetimi i vlerave të kulturës rome**

---

Një detyrë e rëndësishme dhe e përbashkët për të gjithë ne, është ruajtja e vlerave kulturore të minoritetit dhe brënda kësaj, kulturen e minoritetit rom e cila deri tani ka qënë në shkallën më të ulët, si dhe kujdesi për gjuhën rome dhe transmetimi i tyre tek brezat e ardhshëm.

Ky aktivitet nuk duhet të kufizohet vetëm tek popullsia rome. Duke mësuar rreth kulturës rome dhe vlerave shoqërore rome në përgjithësi, shoqëria maxhoritare duhet të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të pakësimit të paragjykimeve prezente në disa grupe brënda shoqërisë dhe të rrisë nivelin e solidaritetit dhe të tolerancës shoqërore.

Vetë minoriteti rom vlerësohet për ruajtjen e gjuhës dhe traditës së tyre të pasur. OJF-të rome luajnë një rol të rëndësishëm për forcimin e identitetit kulturor, ringjalljen, pasurimin dhe transmetimin e vlerave dhe gjuhës, brez pas brezi. Përmes kërkimeve, studimeve, përmbledhjeve dhe botimeve, organizatat që veprojnë në fushën kulturore, kanë dhënë një vizion të ri për traditën rome, kanë rritur respektin dhe vetë vlerësimin brënda komunitetit rom dhe kanë ndryshuar qëndrimet e shoqërisë ndaj ketij minoriteti.

---

**Mbështetja financiare dhe ndarja e përgjegjësive për përmirësimin e gjendjes ekonomike**

---

Në fushën e financimit të programeve të qeverisë duhet të bëhen përpjekje, për të siguruar shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë pjesën e nevojshme të financimit në drejtim të strehimit, të ndihmës së zhvillimit rural dhe rajonal, të tregut të punës etj.

Aktualisht funksionojnë disa shoqata të cilat kanë objekte të ndryshme të aktivitetit si kulturë, arsim parashkollor etj. siç janë romët për Integrim, Amaro-Drom, Romani

Baxt, Shanci Rom, Amaro Kham, Amaro-Dives, Disutni Albania, Alba-Rom etj. Megjithëse numri i shoqatave rome në Shqipëri është rritur këto vitet e fundit, përpjekjet e tyre për të sjellë ndryshime pozitive në situatën rome kanë qënë të pamjaftueshme, që të mos përmëdim disa që kanë ndikuar negativisht.

Gjatë këtyre viteve ato kanë realizuar shumë projekte si botime gazetash, hapje shkollash dhe kopshte parashkollore, kampionate futbollit, ekspozita fotografike, botime librash, ngritjen e qendrave sociale, ngritjen e shkollave verore, koncerte për fëmijë, tryeza të rrumbullakta për problemet e romëve. Për këto projekte kanë financuar institucione dhe organizata brënda dhe jashtë vendit si OSCE, etj

Në procesin e zbatimit të kësaj strategjie komuniteti rom dhe OJF-të rome kanë marrë përgjegjësitë e tyre për realizimin e objektivave dhe masave prioritare.

---

### Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ndalimi i praktikave diskriminuese

---

Qeveria shqiptare duke synuar të përmirësojë jetën e qytetarëve shqiptarë nuk bën dallime dhe ndalon me ligj praktikën dhe sjelljet diskriminuese. Kjo është realizuar nëpërmjet legjislativës dhe institucioneve shqiptare dhe adoptimit të instrumentave ndërkombëtare në këtë fushë. Minoriteti rom nuk ka qënë objekt diskriminimi nga ana ligjore ndonëse janë konstatuar raste të diskriminimit të fshehtë nga ana e individëve të veçantë qoftë këta dhe me pushtet.

---

### Gjendja sociale dhe ekonomike e romëve

---

Kushtet e varfëra të jetesës dhe situata e pafavorizuar sociale e banorëve romë që jetojnë në Shqipëri janë probleme që po u kushtohet vëmendje nga strukturat qeveritare, si dhe opinioni publik. Treguesit socialë për popullsinë rome janë konsideruar më të ulët se mesatarja kombëtare, dhe një pjesë e madhe e minoritetit rom jeton në mes të kushteve të pasigurta, të pambrojtur dhe nën nivelin mesatar të

jetesës.

Papunësia masive pas viteve 90 goditi romët, ata më shumë se çdo grup tjetër e gjetën veten të nxjerrë jashtë nga tregu i punës, duke e patur të vështirë përfshirjen me kërkesat e tregut të ri të punës.

Raporti i banorëve romë që përfundonin arsimin e detyruar para viteve 90, kishte tregues mjaft të mire dhe ishte pothuaj i barabartë me atë të vazhdimin të shkollës nga fëmijët e tjerë shqiptarë. Në drejtim të vazhdimin të arsimit të mesëm dhe të lartë, niveli i pjesëmarrjes regjistron shifra të ulta nga komuniteti rom. Pas viteve 90 sistemi arsimor pësoi një tkurrje dhe u vunë re fenomene të braktisjes së shkollës në shifra shumë të larta .

Situata e vështirë e minoritetit rom në Shqipëri është e një natyrë të përbërë. Është një mangësi sociale që ata kanë një nivel të ulët kualifikimi, numri mesatar i anëtarëve të familjes është i lartë, ndërkohë që gjendja shëndetësore dhe parajkykimet e hedhura në drejtim të tyre pengojnë lëvizshmërinë e tyre sociale. Shumica e romëve jetojnë në pjesë të vendit me infrastrukturë jo të zhvilluar të ndikuara nga krizat ekonomike, dhe në vendbanime të varfëra me një nivel më të ulët se mesatarja. Në shumicën e rasteve problemet e mësipërme janë prezente bashkë dhe kjo luan rolin e vet në marxhinalizimin dhe përjashtimin e popullsisë rome.

Probleme të cilat kërkojnë zgjidhje janë të shumta dhe kanë të bëjnë me gjendjen aktuale të kësaj shtrese të popullsisë. Aspekti akumulues i të gjithë këtyre faktorëve jo favorizues përkeqëson situatën e minoritetit rom. Familjet rome me shumë anëtarë, të cilët nuk kanë të ardhura dhe kanë humbur punën, nuk janë në gjendje të sigurojnë të paktën një jetesë modeste dhe nuk mund të përballojnë strehimin në banesa me kushte të pranueshme dhe pagesën e faturave të shërbimeve publike. Kjo çon në lëvizjen e tyre drejt vendstrehimeve ku ata janë të detyruar të jetojnë në kushte jo të shëndetshme dhe që nuk kanë status legal. Kështu që ata bëhen akoma dhe më të distancuar nga shërbimet publike, shkollat dhe mundësitë e punësimit.

Situata e romëve nuk mund të thjeshtëzohet si një problem varfërie ose si çështje e një politike minoriteti. Në shqyrtimin e çështjes është e dukshme se në praktikë konstatohen raste të përjashtimit dhe të vetëpërjashtimit si rezultat i rrethanave, si ekonomike, sociologjike dhe psikologjike.

Minoriteti rom është i shpërndarë pothuajse në të gjitha zonat, kjo e lidhur ngushtë dhe me elementë të kulturës së tyre. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj pakice përballë me vështirësi të mëdha përse i përket strehimit, arsimit, punësimit, pra nuk ka një gjendje të qëndrueshme ekonomike e sociale. Kjo ndryshueshmëri ndikon në gjetjen e zgjidhjeve afatgjata dhe anasjelltas. Karakteristikat e jetesës dhe familjes rome kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës, dhe mundësitë janë shumë më të kufizuara se pjesa tjetër e popullsisë dhe si rezultat sjellin qarkullimin e varfërisë dhe të problemeve sociale në një cilël të mbyllur, i trashëguar nëpër breza.

Gjithashtu mungesa e informacionit rreth edukimit seksual dhe programeve të planifikimit familjar bëjnë që familjet rome të jenë të zgjeruara dhe me shumë fëmijë. Familje të tilla e kanë të vështirë funksionimin e tyre të plotë në kushtet e ekonomisë së tregut, mundësi të pakta të punësimit dhe paaftësi për të gjetur zgjidhje afatmesme dhe afatgjata për të përmbushur nevojat. Shumica e familjeve të këtij komuniteti, për vetë nivelin shumë të ulët ekonomik, kulturore e arsimor, vuajnë edhe nga probleme të mprehta sociale si dhuna, mosrespektimi i të drejtave të grave dhe fëmijëve, divorcet, abuzimi me alkoolin, vështirësi në administrimin e të ardhurave, shtatzaninë në adoleshencë, etj. Këto familje bien shpesh pre e personave të tretë, të cilët e kanë kontigjentin e parë për llojet e ndryshme të trafikëve, si dhe për shfrytëzim prostitucioni të grave e vajzave, trafikun e organeve, shpesh me dëshirën e prindërve dhe shfrytëzojnë punën e tyre si brënda dhe jashtë vendit. Këta fëmijë në shumë raste me dijeninë e prindërve, nën kujdesin e një personi, shpesh i afërm i familjes lypin, shesin, përfshihen me detyrim në aktivitete të paligjshme, deri në shfrytëzim për prostitucion ose veprimtari abuzuese seksuale.

Fenomeni i trafikimit të fëmijëve ndodh në të gjithë popullsinë, por është më i spikatur në komunitetin e pakicave të lartpërmendura për vetë faktin e shfrytëzimit të familjeve vulnerabile ose "gjysmë" familjeve, vetëm me një nga prindërit ose shpesh me gjyshërit, me prindër të divorcuar etj..

Të dhënat tregojnë se papunësia e romëve është në shifra relativisht të larta në rrethet Tiranë, Korçë, Fushë Krujë etj. Një pakicë e popullsisë rome është relativisht e integruar në jetën shqiptare dhe kjo ndodh kryesisht në qytetet ku ata kanë adoptuar një mënyrë të përafërt jetese me popullsinë maxhoritare.

Reformat strukturore, institucionalizimi i tregjeve, liberalizimi i çmimeve dhe proceset ristrukturose të ekonomisë, megjithë oportunitetet e gjëra që krijuan, u shoqëruan edhe me përkeqësimin e disa treguesve të nivelit të jetesës, me uljen e fuqisë blerëse të popullsisë, me rritjen e papunësisë etj. kosto të cilat i "paguajnë" veçanërisht grupet me të prekshme të popullsisë, përfshirë edhe komunitetin rom.

Emigracioni dhe migracioni janë dukuri sociale karakteristike të tranzicionit. Shqipëria ka ritmet me të larta të emigracionit krahasuar me vendet e tjera të Evropës Lindore dhe Qendrore. Krahas ndikimit pozitiv në drejtim të përmirësimit të jetës ekonomike të familjeve shqiptare, emigrimi sjell dhe pasoja të ndjeshme në fushën sociale (largimi i krahut të punës, rritja e numrit të grave familjare, rritja e numrit të fëmijëve të pashoqëruar, të moshuarit e braktisur, shfrytëzimi i minoreneve nga rrjete kriminale etj).

Duke mos u ndjerë në kushte sociale dhe ekonomike të barabarta, shumë të rinj dhe familjarë romë, emigrojnë në vendet fqinje për një jetë me të mirë. Kjo është dhe një nga arsyt kryesore që çon në trafikimin e fëmijëve dhe vajzave rome, që përgjithësisht bien pre e prostitucionit.

Aktualisht, megjithë ndryshimet ekonomike dhe përmirësimin e nivelit të jetesës për shtresa të caktuara të popullsisë një masë e konsiderueshme jeton nën "vijën zyrtare" të varfërisë dhe trajtohet me ndihmë ekonomike modeste (asistencë në *cash*). Varfëria është para së gjithash një fenomen rural, për faktin se, pjesa më e madhe e popullsisë që jeton në këto zona përballet jo vetëm me të ardhurat e pamjaftueshme por edhe me infrastrukturën e shkatërruar ose jo funksionale, me shërbime të kufizuara sociale etj.

Martesa në moshë të mitur është një arsye që shumë familje rome arrijnë në divorc duke shkaktuar trauma në familje dhe kryesisht tek fëmijët.

Karakteristikë tjetër për komunitetin rom është jeta jostabile e tyre në vendbanime të qëndrueshme. Pasojat që sjell kjo lëvizje e herëpashershme krijojnë probleme për këtë popullsi si dhe për vetë shtetin. Ndryshimi i ambientit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë tek tjetra, vështirësia për t'u ripunësuar dhe integruar me jetën në një tjetër ambient, ka pasoja nga më të ndryshmet. Shumë nga familjet nuk përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike për arsye se lëvizja e tyre nuk është shoqëruar me regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile të vendbanimeve të reja siç është p.sh. rasti i shumë familjeve që jetojnë në Fushë-Krujë, Elbasan, por që është fenomen që ndodh dhe në rrethe të tjera. Në këndvështrimin social, situata social-ekonomike e komunitetit rom reflektohet në një spektër më të gjërë problematikash dhe qëndron në rrënjë të mjaft dukurive sociale (përfshirja e të rinjve në aktivitete kriminale, braktisja e shkollës nga fëmijët, shfrytëzimi i fëmijëve për qëllime përfitimi, prostitucioni, kultivimi dhe përdorimi i drogës, emigracioni, etj.).

# Pjesa e dytë

OBJEKTIVAT, PËRMBAJTJA  
DHE MASAT PRIORITARE  
PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË

## ARSIMI DHE EDUKIMI

Shumë nga fëmijët romë kur nisin klasën e parë nuk dinë gjuhën shqipe për arsye se në familjet e tyre përdoret gjuha romë, e gje e cila i krijon vështirësi në ecurinë në mësim prandaj në të shumtën e rasteve ata detyrohen të lënë shkollën. Për të evituar këtë fenomen do të punohet për edukimin parashkollor të këtij brezi.

Niveli i varfërisë, konceptet e prindërve, niveli i ulët i arsimit të prindërve bëjnë që shumë fëmijë të ndërpresin shkollën për t'u bërë krahë pune për prindërit e tyre. Duke qënë se arsimimi është domosdoshmëri për konkurrencën në tregun e punës është e nevojshme që fëmijët romë të kryejnë arsimin e detyruar si dhe një pjesë tjetër të vazhdojnë studimet në të gjitha nivelet e arsimit.

Për të ndihmuar fëmijët romë për të vazhduar shkollat, duke pasur parasysh dhe vështirësitë ekonomike që kalojnë familjet romë dhe kushtet në të cilat jetojnë, do të ndiqen politika mbështetëse duke dhënë bursa për këtë kategori fëmijësh.

Konkurrenca në tregun e punës kërkon që fëmijët romë të jenë të arsimuar dhe të përgatitur profesionalisht për të zënë vend në administratë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të planifikojë kuota për fëmijët romë që do të vazhdojnë studimet në fusha të ndryshme si administratë publike, shkenca sociale, drejtësi, Akademinë e Rendit dhe atë Ushtatrake, ekonomi, mësuesi etj., në mënyrë që brezi i ri romë gradualisht të punësohet në administratën publike.

---

### Edukimii i fëmijëve parashkollorë

---

Edukimi i fëmijëve parashkollorë do të realizohet nëpërmjet: (i) evidentimit të numrit të fëmijëve që duhet të frekuentojnë kopshtet; (ii) evidentimit të frekuentimit të kopshteve nga fëmijët romë; (iii) sensibilizimit të opinionit rom për domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijëve rom në kopshte; (iv) evidentimit të kapaciteteve thithëse të objekteve parashkollorë në zonat ku banon minoriteti rom dhe sugjerime për të ardhmen, (v) rikonstruksionin e kopshteve që janë në gjëndje jo të mirë në zonat ku banon komuniteti rom; (vi) ngritjen e objekteve të reja në zonat ku aktualisht nuk ka kopshte për fëmijë sipas nevojave që lidhen me numrin e fëmijëve; (vii) domosdoshmërisë së mësimin të gjuhës shqipe për grupin e tretë të arsimit parashkollor për t'i përgatitur fëmijët për klasën e parë; si dhe (viii) emërimin e edukatoreve me përvojë duke marrë më parë mendimin e minoritetit.

---

### Arsimimi dhe problemet e ecurisë së tij me nxënësit romë

---

Arsimimi i fëmijëve romë do të realizohet nëpërmjet: (i) evidentimit të numrit të nxënësve që duhet të frekuentojnë shkollën; (ii) evidentimit të gjëndjes së frekuentimit të shkollës; (iii) sensibilizimit të opinionit rom për regjistrimin e nxënësve në shkolla e cila do të bëhet vazhdimisht; (iv) duke marrë masa ndëshkimore ndaj familjeve që nuk çojnë fëmijët në shkolla; (v) si dhe duke evidentuar kapacitetet thithëse të objekteve shkollorë në zonat ku banojnë romët dhe sugjerime për të ardhmen; (vi) për shkollat që kanë nevojë për rikonstruksione ose (vii) ngritjen e shkollave të reja në funksion të kërkesave të numrit të nxënësve; (viii) duke caktuar në këto shkolla mësues me përvojë duke i kualifikuar dhe stimuluar ata por në të njëjtën kohë (ix) duke stimuluar dhe nxënësit nëpërmjet dhënies falas të teksteve shkollorë për ciklin e ulët dhe tetëvjeçar (klasa I-XIII), si dhe (x) duke organizuar aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës; (xi) duke intensifikuar punën me prindërit romë për ndërgjegjësimin e tyre për një qëndrim dhe vlerësim sa më pozitiv ndaj shkollës si dhe (xii) duke pajisur shkollat me bazë materiale didaktike të nevojshme për ta bërë sa më tërheqës mësimin; (xiii) si dhe me laboratorë të gjuhëve të huaja dhe të informatikës, ndërsa (xiv) për shkollat e mesme profesionale, ku numri i nxënësve romë është i konsiderueshem do të hapen kurse për gjuhën romë si dhe kurse trajnimi sipas natyrës së shkollës, traditës dhe prirjeve të tyre; (xv) për nxënësit që kanë vështirësi për të folur gjuhën shqipe në klasën e parë do të organizohen kurse për mësimin e gjuhës shqipe si dhe (xvi) do të praktikohet organizimi i shkollave verore me nxënës romë dhe jo romë; si dhe (xvii) do të bëhet punë e diferencuar në shkolla për evidentimin e talenteve me qëllim që t'u krijojnë mundësinë atyre për të konkuruar në shkollat artistike dhe profesionale. (xviii) Për eliminimin e analfabetizimit do të hapen kurse për të rriturit që kanë braktisur shkollat.



---

**Bursa dhe programe të tjera mbështetëse për fëmijët romë**

---

Arsimimi dhe edukimi do të stimulohet më tepër nëpërmjet dhënies së bursave dhe programeve të tjera mbështetëse për fëmijët romë: (i) duke emëruar gradualisht punonjës sociale në shkolla me numër të konsiderueshëm nxënësish romë; dhe (ii) duke organizuar veprimtari edukative në shkollë dhe jashtë saj me synim për të nxitur nxënësit dhe prindërit e tyre për të vazhduar shkollat e mesme dhe të larta; (iii) duke planifikuar kuota të veçanta për nxënësit romë që konkurojnë në shkollat e larta; si dhe (iv) për fëmijët me të ardhura të pakta do të jepen bursa nga shteti.

---

**Arsimimi në shkolla me specialitete**

---

Arsimimi në shkolla me specialitete që destinohen kryesisht në shërbime dhe administratën publike, shkencat sociale, Akademinë e Rendit, Akademinë Ushtarake, drejtësi, ekonomi, mësuesi etj.

Për arsimimin në shkolla të larta (i) do të parashikohen kuota për fëmijët e komunitetit

rom.

### TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FAMILJA

#### Familja

Për të integruar komunitetin rom në jetën e shoqërisë është e nevojshme ndryshimi i koncepteve për mënyrën e të jetuarit e cila kërkon shumë kohë duke marrë parasysh traditën, jetesën e tyre në komunitet, martesat e vajzave në moshë të mitur, dhunës ndaj gruas në familje etj.

Gruaja rome në kushtet e sotme është e shtypur dhe e diskriminuar në familje, në të shumtën e rasteve është shtëpiake dhe e pashkolluar dhe aktualisht ajo shërben për lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Duke qënë se gruaja si nënë luan rol në edukimin e fëmijëve të saj është e domosdoshme që ajo të jetë e integruar në shoqëri, të jetë e arsimuar dhe të krijojë të ardhura për familjen e saj duke u punësuar. Punësimi, formimi profesional, njohja me të drejtat që asaj i jep ligji, janë disa nga rrugët që do të ndiqen për integrimin e saj në shoqëri.

#### *Ndryshimi i koncepteve mbi mënyrën e jetesës në familje*

Për të ndryshuar konceptet mbi mënyrën e jetesës në familje kërkohet një periudhë e gjatë kohe e cila do të fillojë me: i) një studim për njohjen e konceptit të familjes rome i cili do të realizohet nga Komiteti për Mundësi të Barabarta në bashkëpunim me OJF-të e grave dhe të fëmijëve si dhe OJF-të rome; duke vazhduar me (ii) takime dhe intervista në familjet e komunitetit rom; (iii) sensibilizime dhe trajnime për të drejtat që u takojnë sipas dokumentave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar; si dhe (iv) duke shpërndarë postera , fletëpalosje dhe duke bërë emisione televizive në median elektronike publike dhe private. Ndryshimi i koncepteve është një objektivat afatgjatë dhe është i lidhur ngushtë me realizimin e objektivave që përmban kjo strategji në të gjithë fushat e jetës së minoritetit rom.

#### *Gruaja në familjet rome, masa për eliminimin e diskriminimit, programe speciale për gratë dhe vajzat*

Duke qënë se gruaja në familjen rome është e diskriminuar për arsye të nivelit të ulët të arsimimit dhe pjesëmarrjes së saj në jetën shoqërore do të merren masa për eliminimin e diskriminimit të saj në familje nëpërmjet (ii) organizimit të programeve të formimit profesional dhe punësimit të grave dhe vajzave duke parë me prioritet gratë kryefamiljare dhe vajzat e trafikuar .

#### Kultura

Komuniteti rom në shekuj e ka ruajtur dhe transmetuar kulturën dhe traditën e tij të pasur deri në ditët tona pavarësisht nga fakti që ata kanë lëvizur në mënyrë të vazhduar. Duke e konsideruar një pasuri të madhe, shteti shqiptar do të ndjekë politika për ruajtjen dhe transmetimin e vlerave të kulturës dhe historinë rome.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në festivale të ndryshme shoqëria shqiptare do të informohet mbi vlerat që intelektualët, shkrimtarët, poetët, muzikantët dhe artistët romë kanë dhënë, ndihmesën e tyre për kulturën kombëtare dhe atë universale. Një spektër i gjërë i shoqërisë do të njohë kulturën rome, zakonet e traditat e saj kulturore dhe shoqërore.

#### *Mbështetje për kulturën dhe historinë rome*

Për ruajtjen e vlerave kulturore të minoritetit rom është menduar t'i jepet (i) mbështetje kulturës dhe historisë rome duke e përfshirë atë në festivalet kombëtare të përvitshme të trashëgimisë siç është Festivali Folklorik Tipologjik i Sazeve që zhvillohet në qytetin e Korçës, Festivali Folklorik Tipologjik i Këngës Popullore Mbarëqytetare që zhvillohet në Elbasan; si dhe përfshirja (ii) në projektet e turizmit kulturor siç janë Festivali i Fyellit Magjik, Festivali Ndërkombëtar CIOFF-it, Festivali i valles dyshe dhe Festivali i Veglave Popullore; (iii) përfshirja në kolanën muzikore zyrtare të trashëgimisë "Trashëgimia shpirtërore në CD", duke bërë regjistrimin e materialit muzikor dhe përgatitjen e masterit, kryerjen e studimit shkencor mbi këtë material, pjesë e tekstit të CD (shqip dhe anglisht), duke riprodhuar 1000 copë CD me këtë traditë muzikore dhe duke bërë shpërndarjen e tyre në institucionet e kulturës, shkencës dhe të arsimit. (iv) Gjithashtu do të kryhen ekspedita të përbashkëta gjurmuese dhe mbledhëse me Akademinë e Shkencave ,ekspozita fotografike, botime të ndryshme si përralla për fëmijë, transkriptime muzikore dhe organizim pavionesh etnografike dhe

zejeve të ndryshme të traditës rome; (v) duke nxitur anëtarësimin e shoqatave kulturore rome në organizma ndërkombëtare si p.sh. në seksionin shqiptar të CIOFF-it; dhe në vazhdim është menduar (vi) hartimi i një projekti pilot për ngritjen e një biblioteke publike dhe qendër informacioni pranë vendbanimeve të mëdha rome.

---

## Rinia

---

Rinia rome duhet të integrohet me të rinjtë e tjerë duke e konsideruar si pjesa me aktive dhe e ndryshueshme e familjes e cila do të sjelle me kalimin e kohës ndryshime në konceptet e jetesës. Të rinjtë veçanërisht janë shumë të ndjeshëm ndaj paragjyqimeve.

Është shumë më e lehtë që të largosh nga mendja mendime të vjetëruara në moshë të re, se sa më vonë në jetë.

Kjo është arsyeja pse rritja e kontakteve ndërmjet komuniteteve të të rinjve romë dhe jo-romë duhet të nxitet si në planin e punës ashtu edhe nëpërmjet skemave të tjera – programeve të përbashkëta, festivaleve, sportit etj. – dhe do t'u jepen më shumë mundësi këtyre të rinjve që të njohin njëri-tjetrin.

### *Përfshirja e rinisë rome në Strategjinë Kombëtare të Rinisë*

Duke qënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është duke hartuar Strategjinë Kombëtare të Rinisë është menduar të përfshihet rinia rome nëpërmjet: (i) evidentimit të individëve dhe grupeve që do të përfshije kjo strategji; (ii) duke krijuar kushte të caktuara për promovimin e aktiviteteve të organizatave rinore rome, gjetjen e alternativave të punësimit rinor, pjesëmarrjen e tyre në debate dhe diskutime.

---

## Sporti

---

Aktualisht jeta sportive në këtë komunitet është e kufizuar vetëm me një ekip futbollit për të rinj. Duke e parë sportin si një mjet që shërben për kalitjen e shëndetit, forcimin e lidhjeve midis njëri-tjetrit, kalitjen e vullnetit etj., do të ngrihen klube sportive për lloje të ndryshme sporti.

### *Gjallërimi i jetës sportive për këtë komunitet*

Për të gjallëruar jetën sportive të këtij komuniteti është e nevojshme; (i) krijimi i klubeve për lloje të ndryshme sporti; (ii) krijimi i ambienteve për realizimin e stërvitjeve; si dhe (iii) përgatitjen e trajnerëve të cilët do të drejtojnë këto klube.

---

## Media

---

Media luan një rol kyç për ndryshimin e stereotipeve dhe në krijimin e një kuadri realist për pasqyrimin e realitetit.

Është e nevojshme që të prezantohet në mediat e shkruara dhe ato elektronike, suksesi i iniciativës lokale dhe proceseve që nxisin integrimin social të romëve. Në media do të krijohen hapësira për të informuar për pjesëmarrjen e aktiviteteve rome si dhe organizimin në jetë dhe zhvillimin e vendbanimeve dhe zonave ku ata jetojnë. Është shumë e rëndësishme që të transmetohen shëmbuj që reflektojnë deformimin e imazhit të komunitetit rom, kontributin që ata japin për rregullimin e ambienteve të tyre, aktivitetet kulturore që organizojnë, arritjet e drejtuesve romë, ndërmarrjet dhe intelektuale të komunitetit përkatës dhe në gjithë shoqërinë.

### *Akses në mediat publike*

Media si pushtet i katërt, do të mbështesë komunitetin rom, që të ketë aksesin e tij në media e cila do të realizohet nëpërmjet: (i) programeve televizive dhe publikimeve në median e shkruar dhe elektronike publike dhe private; (ii) duke mbështetur emisione dhe botime periodike në mbrojtje të të drejtave të komunitetit rom, propagandimit të vlerave të tij; dhe (iii) organizimit të emisioneve për denoncimin e rasteve të diskriminimit dhe deformimit të imazhit të këtij komuniteti.

# EKONOMIA, PUNËSIMI, ULJA E VARFËRISË DHE MBROJTJA SOCIALE

### Zhvillimi i biznesit

Punësimi, ngritja dhe zhvillimi i bizneseve, përfitimi nga programet e nxitjes së punësimit dhe formimit profesional janë disa nga mënyrat për uljen e varfërisë dhe integrimin e kësaj pakice në jetën e shoqërisë maxhoritare.

*Inkurajimi dhe ndihmë speciale në fushat e konsulencës, studimit të tregut dhe mjeteve financiare për krijimin e bizneseve nga ana e komunitetit rom*

Për inkurajimin dhe ndihmen speciale në fushën e konsulencës, studimit të tregut dhe mjeteve financiare për krijimin e bizneseve nga ana e komunitetit rom, është e domosdoshme: (i) evidentimi i bizneseve tradicionale; (ii) bashkëpunimi midis organizatave të biznesit rom dhe organizatave financuese si dhe (iii) ndihmë e konsulence në manaxhim të bizneseve.

### Punësimi dhe formimi profesional

Një pjesë e madhe e të papunëve dhe persona joaktivë të minoritetit rom kanë qenë të papunë për një periudhë disavjeçare dhe midis tyre pjesa më e madhe nuk janë në gjendje që të gjejnë punë edhe nëse ekonomia vazhdon të rritet.

Janë pesë arsye kryesore për nivelet e larta të papunësisë afatgjatë: (i) mungesa e shkollimit; (ii) disavantazhet rajonale; (iii) disavantazhet nga pikëpamja e romëve, që vjen si rezultat i transformimeve strukturore ekonomike; (iv) diskriminimi; dhe (v) efiçenca e ulët e politikave aktive të punësimit të romëve, kjo për shkak se pjesa më e madhe e tyre nuk janë të regjistruar si të papunë.

Duke u bazuar në vëzhgimet e bëra këto vitet e fundit, jo vetëm që një pjesë e madhe e romëve kanë humbur punët e tyre, por gjithashtu janë përjashtuar nga tregu i punës, kjo në një shkallë shumë të lartë, që e tejkalon mesataren e shoqërisë, por ata romë që kanë qenë në gjendje të qëndrojnë pak a shumë në pozicionin e tyre në tregun e punës, kanë qenë në gjendje ta bëjnë këtë duke i detyruar që të heqin dorë nga shanset për të patur një punë të rregullt (pra të punojnë në të zezë).

Në fushën e tregut të punës është jetësore të ngremë përqindjen e skemave për trajnimin e të punësuarve, përveç trajnimeve të tipit shkollor.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me pushtetin vendor do të krijojë programe për papunësinë afatgjatë, e cila duhet të bazohet në bashkëpunim me qendrat e trajnimit, dhe përpjekjet për të bashkuar programet trajnuese me projektet e punëve publike .

Në përfundim të papunësisë afatgjatë, është shumë e rëndësishme që Zyrat e Punësimit të mos ofrojnë shërbimet e tyre vetëm të papunëve romë të regjistruar, por gjithashtu të kenë kontakt edhe me të papunët romë që nuk janë të regjistruar.

Me qëllim që të rritet numri i të punësuarve, duhet të nxitin programe speciale të krijuara dhe të formuluar nga vetë romët. Për të siguruar që programet për arritjen e qëllimit të romëve të mos mbeten në letër, punëdhënësit dhe trainuesit që do të merren me romët duhet të marrin një përkrahje në formën e lehtësimeve financiare.

Programet e punëve publike, punësimi lokal i mundësuar nga pushteti vendor, mund të hapin vende pune për njëriqind të punësuarve të larta dhe me arsimim të ulët, me qëllim që këta njerëz të kenë mundësinë që të punojnë dhe të marrin një pagë. Këto lloj programesh tashmë luajnë një rol shumë të rëndësishëm (dhe do të mbeten të tilla dhe në të ardhmen) në sigurimin e një mjeteje jetese për familjet e prekura.

*Zbatimi i programeve speciale të nxitjes së punësimit për komunitetin rom*

Për punësimin dhe formimin profesional do të zbatohen programe speciale të nxitjes së punësimit të cilat (i) do të punësojnë romët në programet e punëve publike me fonde nga buxheti i shtetit si dhe (ii) punësim i punëkërkuarve të papunë, (iii) punësim nëpërmjet formimit profesional dhe (iv) formimit institucional.

*Përdorimi i politikave lehtësuese për ato kompani që punësojnë anëtarë të komunitetit rom*

Ky objektivi do të realizohet: (i) duke studiuar mundësitë e financimit të kompanive ku punëdhënësit dhe punëmarrësit janë nga komuniteti rom; si dhe (ii) duke studiuar mundësinë e krijimit të lehtësirave

fiskale për ato kompani që hapin vende pune për romët; si dhe (iii) duke mbështetur me bazë materiale, ambiente, mjete financiare dhe burime njerëzore ato biznese që kanë si destinacion produktet e traditës rome.

*Integrimi i komunitetit rom në sistemin e arsimit dhe formimit profesional publik dhe privat*

Për integrimin e komunitetit rom në sistemin e arsimit dhe formimit profesional kërkohet: (i) identifikimi i profesioneve që mund të mësohen nga romët; (ii) hapja e kurseve të formimit profesional për profesionet e identifikuar në qendrat publike dhe private të formimit profesional; (iii) identifikimin e kontigjenteve rome për punësimin e tyre si edukatorë kopshti parashkollor; (iv) trajnimin e këtij kontigjenti të zgjedhur; si dhe (v) punësimin e tyre në institucionet që frekuentohen nga romët; si dhe (vi) duke krijuar kushte lehtësuese për formimin profesional të të papunëve rome, (vii) të mbështetur në një bazë ligjore që stimulon apo lehtëson formimin profesional të romëve.

*Mbështetja e komunave dhe bashkive për futjen e komunitetit rom në tregun e punës*

Përfshirja e komunitetit rom në tregun e punës kërkon mobilizimin e të gjithë strukturave të shtetit duke nisur nga pushteti vendor ku: (i) komunat dhe bashkitë të evidentojnë kërkesat për punë dhe profesione të këtij komuniteti; (ii) të analizojnë jo me pak se dy herë në vit shkallën e papunësisë së tyre, (iii) si dhe të financojnë projekte të punëve publike në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së vendbanimeve .

---

## Mbrojtja sociale

---

Shteti shqiptar do të ndihmojë shtresat në nevojë të minoritetit rom siç janë fëmijët e rrugës, familjet me të ardhura të pakta, të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit.

*Integrimi i fëmijëve rom të rrugës në jetën normale*

Për integrimin e këtij grupi fëmijësh është menduar: (i) ngritja e qendrave ditore të cilat do të shërbejnë si strehë dhe shkollë, që do të realizohen (ii) në bashkëpunim me donatorë vendas dhe të huaj, OJF që zbatojnë projekte në edukimin dhe zhvillimin e kësaj kategorie fëmijësh. Institucione shtetërore si Inspektoriati Shtetëror i Punës (iii) do të ushtrojë kontrolle sistematike lidhur me punën e zezë të fëmijëve rome.

*Asistencë për aplikimin e ndihmës ekonomike për familjet e varfëra*

Duke qënë se shumë familje rome nuk përfitojnë ndihmë ekonomike për arësye se nuk njohin të drejtat që janë të garantuara në ligj është programuar: (i) organizimi i një fushate sensibilizuese në fushën e mbrojtjes sociale për të drejtat e përfitimit për ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë, pagesë barrë lindje dhe të drejta të tjera që lindin nga legjislati në fuqi; si dhe (ii) nxjerrjen e një akti administrativ që detyron komunat dhe bashkitë për t'u dhënë asistencë ligjore familjeve rome për plotësimin e dosjeve.

*Stimulimi dhe mbështetja e shoqatave rome si përfaqësues të aspekteve të ndryshme të jetës së tyre*

Për realizimin e këtij objekti është e domosdoshme; (i) evidentimi dhe regjistrimi i OJF-ve rome që ushtrojnë aktivitete; dhe (ii) krijimi i një rrjeti të këtyre OJF-ve, të cilat (iii) do të bashkëpunojnë me organe të ndryshme vendimarrëse të shtetit po në të njëjtën kohë është menduar se do të ishte shumë efikase (iv) ngritja e një instituti apo qendre integrimi, e cila do të merrej me monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kësaj strategjie.

---

## Kushtet e punës

---

*Marrja e masave për eliminimin e rasteve abuzive të shkeljeve të dispoziatve të legjislati të punës nga punëdhënësit (kushtet e punës, pagat, orari i punës etj.)*

Është e domosdoshme: (i) forcimi i kontrollit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës në subjektet që kanë të punësuar romë; (ii) si dhe duke bërë informim për punëdhënësit dhe punëmarrës romë për të drejtat dhe detyrimet që kanë palët gjatë marrëdhënieve të punës.

---

## Sigurimet shoqërore

---

*Përfshirja e popullsisë aktive rome në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, në kushtet që një pjesë e mirë e romëve merren me aktivitete joformale*

Duke qënë se një pjesë e mirë e popullsisë joaktive rome nuk përfiton nga sigurimet shoqërore për arësye të mospërfshirjes së tyre në skemën e kontributeve është një objektiv afatgjatë që popullsia aktive e këtij komuniteti (i) të marrë informacionin e mjaftueshëm për skemën e sigurimeve shoqërore nëpërmjet mjeteve të informimit publik; si dhe (ii) Instituti i Sigurimeve

Shoqërore në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror të Punës të kontrollojë veprimtarinë informale me qëllim tërheqjen në skemën e sigurimeve, të romëve që punojnë në sektorin privat.

---

## Gjendja civile

---

Numri i saktë i romëve që jetojnë në Shqipëri nuk njihet për arsye se deri tani nuk është bërë regjistrimi i këtij komuniteti por flitet që janë 80-120 mijë. Lëvizja e shpeshë dhe ndryshimi i vendbanimeve, martesat në moshë të vogël, mungesa e njohjes se ligjit kanë bërë që një pjesë e mirë nuk janë të regjistruar në zyrat e gjëndjes civile. Për pasojë shumë prej tyre nuk përfitojnë nga mbështetja financiare që u jep shteti shtresave të varfra dhe në nevojë prandaj del si domosdoshmëri të bëhet një program për regjistrimin e këtij komuniteti.

### *Të regjistrohet popullsia rome në zyrat e gjëndjes civile*

Duke marrë në konsideratë problemet që ka ky komunitet për regjistrimin në zyrat e gjëndjes civile, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (i) do të hartojë një program për regjistrimin e kësaj pjese të popullsisë duke (ii) siguruar mjetet e nevojshme njerëzore, monetare dhe materiale.

# SHËNDETËSIA DHE INFRASTRUKTURA

## Shëndetësia

Kushtet e jetesës dhe disavantazhet e popullsisë janë të lidhura ngushtë me situatën sociale, ekonomike dhe arsimore. Të gjithë këta faktorë përcaktojnë në mënyrë rrënjësore, dhe një ndikim afatgjatë në gjëndjen e shëndetit.

Treguesit për kushtet e jetesës dhe gjëndja shëndetësore e grupeve të komunitetit rom që jetojnë në kushte jo të mira banimi dhe ushqimi, mbeten shumë më poshtë atyre që jetojnë në pjesën maxhoritare të shoqërisë. Një aspekt i varfërisë dhe i diferencimit, është pabarazia në shëndet. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nisjes së një jete të sigurt, dhe kujdesit për fëmijët. Ndihma duhet t'u sigurohet nënave, grave dhe familjeve me qëllim që të krijohet një jetesë e shëndetshme.

### *Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës*

Për të pasur një shëndet të mirë të fëmijës është parashikuar: (i) zbatimi i vaksinimit të detyrueshëm për të gjithë fëmijët nga 0-14 vjeç; (ii) ndërsa për nënën do të organizohen programe promovuese dhe edukativo-shëndetësore për shëndetin riprodhues; (iii) ndërgjegjësimi i komunitetit rom për përdorimin e metodave moderne të planifikimit familjar (rritja e përdorimit të metodave kontrceptive); si dhe (iv) rritja e kujdesit për gruan shtatzënë dhe fëmijën e porsalindur.

### *Asistencë me medikamente dhe ndihma mjekësore për familjet me shumë fëmijë dhe të varfëra*

Rritje e (i) aksesit për shërbim shëndetësor duke përmirësuar strukturën shëndetësore me ndërtimin e qendrave shëndetësore dhe ambulanca sipas shtrirjes së komunitetit rom dhe rregullave në fuqi; (ii) duke evidentuar familjet e varfëra dhe me shumë fëmijë; (iii) do të bëhet trajtimi mjekësor falas në rastet e sëmundjeve për këtë pjesë të komunitetit rom.

### *Vlerësimi i morbozitetit dhe vdekshmërisë në komunitetin rom dhe masat për eliminimin e tyre*

Për të realizuar këtë objektiv është e domosdoshme: (i) evidentimi i sëmundjeve dhe shkaqeve të vdekjeve, si dhe vlerësimi krahasues me pjesën tjetër të popullsisë (pjesën maxhoritare); si dhe (ii) përmirësimi i kushteve mjedisore si higjiena e mjedisit, uji i pijshëm dhe infrastruktura e zonave të banimit të komunitetit rom të cilat do të realizohen nga bashkëpunimi i Ministrisë së Shëndetësisë me pushtetin vendor.

## Kushtet e banimit

Një pjesë e komunitetit rom gjatë viteve të tranzicionit për shkak të varfërisë dhe nivelit të ulët arsimor në vitin 1996 mbeten pa strehim si rezultat i shitjes së shtëpive dhe futjes së lekëve në firmat piramidale dhe aktualisht jetojnë në kushte ekstremisht të keqija, duke improvizuar banesa pa asnjë lloj kushti higjieno-sanitar. Një pjesë tjetër, si rezultat i proceseve të tranzicionit, papunësisë, varfërisë të tejskajshme, nivelit të ulët të arsimimit dhe traditës së hershme jetojnë në ambiente që nuk janë të banueshme, por sa për të mbuluar kokën. Për integrimin e kësaj pjese të komunitetit, shteti në bashkëpunim me vetë komunitetin do të hartojë projekte për strehimin e tyre me kushte normale.

### *Sigurimi i nevojave minimale për strehim*

Për këtë është e domosdoshme: (i) evidentimi i nevojave për strehim duke u nisur nga numri i familjeve që kanë nevojë për strehim, numri i pjesëtarëve të familjes, kushtet aktuale të banimit; (ii) evidentimi i banesave që kanë nevojë për t'u riparuar dhe hartimi i projekteve për rikonstruksionin e tyre; (iii) identifikimin e pronësisë mbi truallin në të cilën është vendosur komuniteti rom; (iv) llogaritjen e nevojave për truall dhe materiale ndërtimi duke stimuluar ndërtimin e banesave nga vetë komuniteti; si dhe (v) ndërtimi i banesave të thjeshta për të pastrehët dhe për ata që banojnë në kushte jo të mira.

### *Mbulimi në rrjetin ujësjellës-kanalizime dhe energji elektrike në gjithë komunitetin*

Në vendbanimet e komunitetit rom pushteti vendor, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në bashkëpunim me komunitetin rom: (i) do të llogarisin nevojat për ujësjellës-kanalizime; (ii) duke dhënë komuniteti kontributin e vet njerëzor në ndërtimin e infrastrukturës; (iii) për të realizuar lidhjen

e rrjetit të brendshëm; (iv) gjithashtu duke përmirësuar kushtet e brendshme higjiëno-sanitare; dhe (v) përmirësime të sistemit elektrik, duke vendosur kabina elektrike në ato zona të komunitetit ku mungojnë.

*Sigurimi i lidhjeve të vendbanimeve me rrugën nacionale*

Për të siguruar levizje të lirë të pjesëtarëve të komunitetit rom në ato zona ku ata jetojnë të veçuar nga pjesa maxhoritare e popullsisë është e nevojëshme (i) kryerja e studimeve dhe hartimi i projekteve për rrjetin e brëndshëm rrugor në rastet kur mungon ose nuk plotëson kërkesat teknike për lëvizje të lirë; si dhe (ii) ndërtimin dhe rikonstruktimin e këtyre rrugëve të brëndshme; (iii) duke mobilizuar vetë komunitetin rom.



### RENDI PUBLIK, DREJTËSIA, ADMINISTRATA PUBLIKE

---

#### Rendi

---

Me qëllim që të ulen rastet e diskriminimit në jetën e përditshme, jo vetëm që duhet të dokumentohen rastet e dhunës në familje, trafikimit të vajzave dhe fëmijëve, krimeve ordinere por duhet edhe të hetohen duke rritur ndërhyrjen, duhet të bëhet e mundur që të krijohet një ndjenjë solidariteti kundrejt romëve në mediat publike dhe në krijimin e një opinioni të përgjithshëm.

*Evidentimi i llojeve të krimit tek komuniteti rom dhe masat për uljen e tyre*

Evidentimi (i) dhe lufta për parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe vajzave romë, si dhe parandalimin e krimeve ordinere; (ii) marrjen e masave efektive për parandalimin e kërcënimeve nga individë të veçantë në rradhët e policisë; (iii) studimi i rasteve të moszbatimit korrekt të ligjit gjatë ndërhyrjeve dhe kontrolleve që bën policia .

*Përfshirja e anëtarëve të komunitetit rom në efektivat e policisë në ato qarqe ku ata kanë komunitet*

Përfshirja e anëtarëve të komunitetit rom në efektivat e policisë do të fillojë me: (i) krijimin e hapësirave për të ndihmuar të rinjtë rom në proceset e konkurimit në Akademinë e Rendit; (ii) duke i trajtuar me synim punësimin e tyre si efektiv policie; dhe (iii) duke përcaktuar kuota vjetore për t'i shkolluar të rinjtë rom në Akademinë e Rendit.

*Parandalimi dhe goditja e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, pjesë e komunitetit rom dhe sidomos trafikimit të fëmijëve dhe vajzave për qëllime shfrytëzimi*

Është e rëndësishme: (i) evidentimi i rasteve të trafikuar për të bërë; (ii) parandalimin e këtij fenomeni dhe për të marrë masa për personat e trafikuar; (iii) duke hartuar programe të veçanta për të luftuar fenomenin e trafikimit të cilat do të realizohen nga institucionet e qeverisë shqiptare në bashkëpunim me organizma ndërkombëtare të specializuara në këtë fushë iç është OSBE, UNHCR etj.

PROCEDURAT DHE METODAT  
E NDJEKURA PËR HARTIMIN  
DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË

Pjesa e tretë

## Procedura e ndjekur

Për hartimin e strategjisë "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom" është ngritur një grup pune ndërministror me përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Transportit, Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

Është hartuar programi i punës për Grupin Ndërministror i cili parashikon veprimtaritë e grupit, afatin kohor të realizimit, institucionet dhe personat përgjegjës.

Janë organizuar disa tryeza të rrumbullakta (9-10 Janar 2003 dhe 3 Shkurt 2003) të finacuara nga Këshilli i Evropës dhe OSCE/ODHIR sipas programit "Romët dhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore" me përfaqësues nga Këshilli Evropës, OSCE dhe Komisioni Evropian dhe me pjesëmarrës nga institucionet shqiptare dhe OJF-të rome. Në takimin e datës 3 Shkurt është nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi midis përfaqësuesve të Ministrive dhe të organizatave të minoritetit rom sipas së cilës përfaqësuesit e OJF-ve rome do të jenë partnerë deri në hartimin e dokumentit final të strategjisë.

Për ecurinë e punës, periodikisht, janë informuar përfaqësues të OSCE/ODHIR të cilët kanë ndihmuar grupin ndërministror me asistencën e tyre.

OJF-të rome kanë luajtur rolin e tyre duke dhënë informacion për gjendjen si dhe duke paraqitur problematikën e këtij komuniteti para grupit të punës si dhe kanë dhënë ndihmesë në nëngrupet e ngritura pranë institucioneve të përfaqësuara.

Duke njohur vështirësitë që po kalon aktualisht vendi ynë dhe duke vlerësuar që shumë probleme të minoritetit rom janë edhe probleme të pjesës maxhoritare, grupi i punës është munduar që të përcaktojë zgjidhje për problemet që nuk mbulohen nga strategji të hartuara nga qeveria shqiptare për gjithë popullsinë.

Strategjia "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom", realizohet nëpërmjet këtyre proceseve:

### 1. Procesi i hartimit

- Ngritja e grupit ndërministror
- Hartimi i programit të punës
- Organizimi i tryezave të rrumbullakta
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis përfaqësuesve të Qeverisë shqiptare dhe OJF-ve rome
- Ngritja e nëngrupeve të punës me përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe OJF-ve rome
- Grumbullim i informacionit
- Hartimi i projektit

### 2. Procesi i miratimit

- Tryezë për diskutimin e projekt-strategjisë
- Dërgimi i projekt-strategjisë zv.Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, z.Illir Meta
- Dërgimi i projekt-strategjisë në Këshillin e Ministrave
- Miratim nga Këshilli i Ministrave

### 3. Procesi monitorimit

## Organet monitoruese

Për të siguruar zbatimin e kësaj strategjie është e nevojshme ngritja e një strukture shtetërore (institut ose qendër integrimi) që do të merret me ndjekjen e zbatimit të problemeve dhe masave prioritare të parashikuara në strategji. Kjo strukture mund të jetë e atashuar pranë një dikasteri të specializuar, që do të krijoj hapsira dhe mundësitë për zbatim. Kjo strukturë do të funksionojë menjëherë sapo strategjia të miratohet dhe do të ketë në përberjen e saj 3 deri në 5 specialistë të fushave të tilla si arsimit dhe kultura, specialist i menaxhimit të infrastrukturës urbane, specialist i çështjeve sociale dhe i familjes, specialisti i ekonomisë, biznesit dhe punësimit.

Misioni i kësaj strukture do të jetë bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për të gjetur fondet e nevojshme për të realizuar strategjinë në fushën e investimeve. Qendra do të bashkëpunojë me shoqatat e komunitetit rom për të zgjidhur në mënyrë të vazhdueshme të gjitha problemet që kërkojnë bashkëpunimin dhe bashkëpërgjegjësi me komunitetin përkatës. Detyrë e rëndësishme e qendrës do të jetë nxitja e organeve të ndryshme shtetërore për të përfshirë në planet e tyre të zhvillimit objektivat e parashikuara në strategji. Integrimi i vazhdueshëm dhe ndjekja

e treguesve të monitorimit si dhe raportimi në dikasterin përkatës ose në Këshillin e Ministrave do të jetë objektiv i punës së këtij institucioni. Detyra të tjera më specifike do të detajohen me krijimin e këtij institucioni.

---

## Treguesit e monitorimit

---

Me qëllim që të ndiqet realizimi konkret i Strategjisë , lind nevoja e hartimit të një seri treguesish me të cilët do të bëhet e matshme puna që do të bëhet në këtë drejtim. Këto tregues do të jenë shprehje sasiore e fenomenit ose masës së parashikuar për tu marrë dhe do të shprehin realizimin faktik të saj. Sistemi i treguesve mund të jetë i shumëllojshëm dhe në një numër të madh , gjithashtu ato mund të jenë tregues fleksibël që do të thotë se mund të përdoren për një kohë të caktuar dhe me përfundimin e tyre, objektiva tregues të tjerë do të zënë vendin e tyre.

Parimi i ndërtimit të treguesve do të jetë evidentimi i realizimit të objektivave themelore të parashikuara në tërësinë e masave prioritare. Në formë të përgjithëshme këto tregues mund të paraqiten si vijon:

1. Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopeshtet në raport me numrin e përgjithshëm të fëmijëve rom.
2. Numri i nxënësve që frekuentojnë shkollat në të gjitha nivelet e arsimit dhe përqindja e frekuentimit të shkollave sipas grup moshave të fëmijëve rome. (nga cikli i ulët deri në Universitet).
3. Numri i edukatorëve dhe mësuesve romë të përgatitur për të dhënë mësim në shkolla dhe kopshte.
4. Numri i bursave të akorduara për nxënësit rome;
5. Numri i nxënësve rom që do të ndjekin studimet për specialitete të destinuar për të punuar në sektorët publikë si në Shkencat ekonomike, shkencat sociale, Akademia e rendit, akademia ushtarake, drejtësi, mësuesi, administrim publik etj.
6. Numri i martesave të kryera para moshës 16 vjeç.
7. Numri i grave të punësuar në sektorin publik dhe privat.
8. Pjesëmarrja dhe stimulimi i grupeve aristike rome në të gjithë veprimtaritë artistike sipas kalendarit artistik të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
9. Numri i grupeve kulturore, artistike dhe sportive të krijuara pranë komuniteteve rome.
10. Numri i programeve televizive, publikimeve në median e shkruar, botimeve periodike për komunitetin rom.
11. Numri i bizneseve rome të krijuar dhe numri i të punësuarve në to.
12. Përqindja e të papunëve rome sipas rajoneve të banimit.
13. Fondet e akorduara për komunitetin rom në fushën e punësimit.
14. Ulja e numrit të fëmijëve rom të rrugës duke i integruar në jetën normale.
15. Përfundimi i regjistrimit të popullsisë rome në zyrat e gjëndjes civile.
16. Numri i familjeve rome që marrin ndihme ekonomike.
17. Numri i personave rom që dalin në pension çdo vit.
18. Numri i qendrave shëndetsore, mjekëve dhe personelit tjetër për 1000 banorë në komunitetin rom.
19. Ulja e morbozitetit dhe mortalitetit në këtë komunitet.
20. Numri i apartamenteve të ndërtuara me destinacion komunitetin rom.
21. Numri i vajzave dhe fëmijëve të trafikuar.
22. Numri i personave të punësuar në rend, administratë publike dhe sektore të tjerë publik.

Strategjia Kombëtare  
"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"

KAPITULLI I - ARSIMI DHE EDUKIMI

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
I	<b>Arsimi dhe edukimi</b>	1. Edukimi i fëmijëve parashkollorë	<p>1.1 Evidentimi i gjëndjes së numrit të fëmijëve që duhet të frekuentojnë kopshtet.</p> <p>1.2 Evidentimi i gjëndjes së frekuentimit të kopshteve nga fëmijët Romë.</p> <p>1.3 Sensibilizimi i opinionit Rom për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte.</p> <p>1.4 Evidentimi i kapaciteteve thithëse të objekteve parashkollorë në zonat që banohen nga Romët dhe sugjerime për të ardhmen.</p> <p>1.5 Rikonstruksioni i kopshteve në zonat e komunitetit Rom.</p> <p>1.6 Ngritja e objekteve të reja në zonat e banuara nga Romët sipas nevojave që lidhen me numrin e fëmijëve.</p> <p>1.7 Për grupin e tretë të arsimit parashkollor do të ngrihen kurse për mësimin e gjuhës shqipe për ti përgatitur për klasën e parë.</p> <p>1.8 Emërimi i edukatoreve me përvojë duke marrë dhe mendimin e komunitetit Rom.</p> <p>2.1 Evidentimi i numrit të nxënësve që duhet të frekuentojnë shkollën.</p> <p>2.2 Evidentimi i gjëndjes së frekuentimit të shkollës nga nxënësit Romë.</p> <p>2.3 Sensibilizimi i opinionit Rom për rregjistrimin e nxënësve në shkollë.</p>	<p>DA-OJF Rome</p> <p>DA</p> <p>DA-OJF Rome</p> <p>DA</p> <p>MASH-DA</p> <p>MASH-DA</p> <p>DA</p> <p>DA -komuniteti Rom</p> <p>DA- DSH</p> <p>DA-DSH-Komuniteti Rom</p> <p>DA-DSH</p>	<p>2003 e ne vazhdimesi</p> <p>2003 e ne vazhdimesi</p> <p>Ne vazhdimesi</p> <p>Ne vazhdimesi</p> <p>2004-nne vazhdim</p> <p>2004-nne vazhdim</p> <p>Çdo vit duke filluar nga 2004</p> <p>Vazhdimisht</p> <p>Vazhdimisht</p> <p>Çdo vit</p> <p>Çdo vit</p>	<p>-</p> <p>-</p> <p>5 mijë / çdo vit</p> <p>-</p> <p>1 milion</p> <p>5 milion</p> <p>250 mijë</p> <p>--</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>5 mijë / çdo vit</p>

*Strategjia Kombëtare  
"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI I - ARSIMI DHE EDUKIMI**

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
			2.4 Vendosja e sanksioneve ndaj familjeve që nuk çojnë fëmijët në shkollë .	MASH - DA	Vazhdimisht	-
			2.5 Evidentimi i kapaciteteve thithëse të objekteve shkollore në zonat që banojnë nga Romët dhe sugjerime për të ardhmen.	DA - OJF	Çdo vit	-
			2.6 Rikonstruksioni i shkollave në zonat e komunitetit Rom.	MASH - DA	2004-ne vazhdim	5 milion
			2.7 Ngritja e dy shkollave të reja në zonat e banuara nga Romët në vartësi me numrin e nxënësve.	MASH - DA	2005-ne vazhdim	2 milion
			2.8 Caktimi i mësuesve me përvojë për drejtimin e klasave me fëmijë Romë, kualifikimi dhe stimulimi i tyre.	MASH - DA	2004-ne vazhdim	-
			2.9 Pajisja e nxënësve të klasave I - VIII me tekste falas.	DA	2004-ne vazhdim	Fondi MASH
			2.10 Thitja e sa më shumë nxënësve Romë në aktivete brenda dhe jashtë shkollës.	DA – DSH	Çdo vit	-
			2.11 Intensifikimi i punës me prindërit Romë për ndërgjegjësimin e tyre për një qendrim dhe vlerësim sa më pozitiv ndaj shkollës.	DA - komuniteti Rom	Çdo vit	-
			2.12 Pajisja e shkollave me bazë materiale didaktike të nevojshme.	DA	Çdo vit	1 milion
			2.13 Pajisja e shkollave me laboratorë të gjuhëve të huaja dhe të informatikës.	MASH - DA	Çdo vit	1 milion
			2.14 Pranë shkollave të mesme profesionale, ku numri i nxënësve Rom është i konsiderueshëm, do të hapen kurse trainimi për gjuhën Rome dhe kurse të tjera sipas natyrës së shkollës, traditës dhe prirjeve të tyre.	MASH	Çdo vit	5 mijë / çdo vit
			2.15 Pranë shkollave të ngrihen kurse për mësimin e gjuhës shqipe për nxënësit Romë që vinë për herë të parë në shkollë dhe ata që kanë mangësi të theksuara në mësimin e gjuhës shqipe.	MASH	Çdo vit	-

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI I - ARSIMI DHE EDUKIMI**

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
			<p>2.16 Të praktikohet organizimi i shkollave verore me nxënës Romë dhe jo Romë.</p> <p>2.17 Të bëhet punë e diferencuar në shkolla për evidentimin e talenteve për të krijuar mundësitë e konkurimit në shkollat e mesme artistike dhe profesionale.</p> <p>2.18 Të hapen kurse për eliminimin e analfabetizmit për të rriturit që kanë braktisur shkollat</p> <p>1.1 Gradualisht, do të emërohen punonjës socialë në shkolla ku ka më tepër nxënës Romë.</p> <p>1.2 Në të gjithë veprimtarinë edukative në shkollë dhe jashtë saj të punohet me synimin që të nxitën nxënësit dhe prindërit e tyre për të vazhduar shkollat e larta.</p> <p>1.3 Do të planifikohen kuota të veçanta për nxënës Romë që konkurojnë për shkollat e larta.</p> <p>1.4 Do të jepen bursa për fëmijët me të ardhura të pakta familjare</p> <p>4.1 Do të parashikohen kuota për fëmijët e komunitetit Rom që janë me rezultate të larta..</p>	<p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH</p> <p>MASH, MRP, DAP</p>	<p>Çdo vit</p> <p>Çdo vit</p> <p>Çdo vit</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>vazhdimisht</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-ne vazhdim</p>	<p>100 mijë</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>Fondi MASH</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>50 mijë/çdo vit</p> <p>-</p>
		<p>3.Bursa dhe programe të tjera mbështetëse me fëmijët Romë.</p> <p>4.Arsimimi në shkolla dhe specialitete që destinohen kryesisht në shërbime dhe administratën publike, shkencat sociale, Akademia e Rendit, Akademia Ushtarake, drejtësi, ekonomi, mësuesi etj.</p>				

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI I I - TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FAMILJA**

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha realizimit	Kosto / Euro
I	<b>Familja</b>	1. Ndryshimi i koncepteve mbi mënyrën e jetesës në familje	<p>1.1 Studim për njohjen e konceptit në familjen Rome</p> <p>1.2 Takime dhe intervista me familjet e komunitetit Rom për konceptet e jetesës së këtij komuniteti</p> <p>1.3 Sensibilizim dhe trajnime me familje të komunitetit Rom për të drejtat që u takojnë sipas dokumentave ndërkombëtare dhe ligjislacionit shqiptar</p> <p>1.4 Shpërndarja e posterave ,fletë palosjeve dhe emisione ne media</p>	<p>KMB, MPVD ne bashkepunim me OJF-të e grave dhe femijëve dhe OJF-të Rome</p> <p>KMB,OJF-të</p> <p>KMB,OJF-të</p> <p>KMB,OJF-të</p>	<p>2004</p> <p>vazhdimisht</p> <p>vazhdimisht</p> <p>vazhdimisht</p>	<p>50 mijë</p> <p>-</p> <p>3 mijë / çdo vit</p> <p>3 mijë / çdo vit</p>
II	<b>Kultura</b>	<p>2. Gruaja ne familjet Rome, masa për eliminimin e diskriminimit, programe speciale për gratë dhe vajzat</p> <p>3. Mbështetje për kulturën dhe historinë Rome</p>	<p>2.1 Programe formimi profesional dhe punësimi për gratë dhe vajzat duke parë me prioritet gratë kryefamiljare</p> <p>3.1-Përfshirja e traditës Rome në festivalet kombëtare të përvitshme të trashëgimisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Festivali Folklorik Tipologjik i Sazeve në Korçë</li> <li>➤ FFT i Këngës Popullore Mbarëqytetare në Elbasan</li> </ul> <p>3.2- Përfshirja ne projektet e turizmit kulturor</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Festivali "Fyelli Magjik"-Butrint</li> <li>➤ Festivali ndërkombëtar GIOFF-Përmet</li> <li>➤ Festivali i valles dyshe –Librazhd</li> <li>➤ Festivali i veglave popullore Gjirokastër</li> </ul>	<p>KMB,MPCS</p> <p>MKRS,DTK</p> <p>MKRS,DTK</p>	<p>Vazhdimisht</p> <p>Çdo vit</p> <p>Çdo here që organizohen festivale</p>	<p>100 mijë / çdo vit</p> <p>60 mijë / çdo festival</p> <p>60 mijë / çdo festival</p>



Strategjia Kombëtare  
"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"

KAPITULLI II - TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FAMILJA

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha realizimit	Kosto / Euro
II	<b>Kultura</b>	3. Mbështetje për kulturën dhe historinë Rome	<p>3.3-Përfshirja e komunitetit Rom në kolanen muzikore zyrtare të trashëgimisë "Trashëgimia shpirtërore në CD"</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregjistrimi i materialit muzikor dhe përgatitja e masterit</li> <li>➤ Kryerja e studimit shkencor mbi këtë material, pjesë e tëkstit të CD ( shqip dhe anglisht)</li> <li>➤ Riprodhimi i 1000 cope CD me këtë traditë muzikore</li> <li>➤ Shpërndarja e tyre në institucionet e kultures, aresimore e shkencore</li> </ul> <p>3.4 Kryerja e ekspeditave të përbashketa gjurmuese dhe mbledhese me Akademinë e Shkencave</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ekspozita fotografike nga kjo traditë</li> <li>➤ Botime të kesaj traditë si përralla për femijë etj.</li> <li>➤ Trankiptime muzikore të traditës Rome</li> <li>➤ Organizim pavionesh etnografike dhe zejeve të ndryshme të traditës Rome</li> </ul> <p>3.5 Nxitje të antaresimit të shoqatave kulturore Rome në seksionin shqiptar të CIOFF-it</p> <p>3.6 Hartimi i një projekti pilot për ngritjen e një bibliotëke publike dhe qendre informacioni pranë qendrave të mëdha Rome</p>	<p>MKRS,DTK</p> <p>IKP - ASH</p> <p>CIOFF &amp; MKRS</p> <p>M K R S Drejtoria e Librit</p>	<p>2004- vazhdim</p> <p>2004</p> <p>2004</p> <p>2005</p> <p>2005-ne vazhdim</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-2006</p>	<p>15 mijë</p> <p>36 mijë</p> <p>-</p> <p>110 mijë</p>

*Strategjia Kombëtare  
"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI II - TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FAMILJA**

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjese	Koha realizimit	Kosto / Euro
III	<b>Rinia</b>	4. Përfshirja e rinisë Rome në Strategjinë Kombëtare të Rinisë	4.1 Evidentimi i individëve dhe grupeve përfshirëse në Strategjinë Kombëtare të Rinisë.  4.2 Krijimi i kushteve të caktuara për promovimin e aktiviteteve të organizatave rinore Rome, gjetjen e alternativave të punësimit rinor, pjesëmarrja në debate dhe diskutime.	MRKS, Drejtoria e Kordinimit të Politikave Rinore MRKS  Drejtoria e Kordinimit të Politikave Rinore	Ne vijueshmeri  Vazhdimisht	Fondi MKRS  Fondi MKRS
IV	<b>Sport</b>	5. Gjallërimi i jetës sportive për këtë komunitet	5.1 Krijimi i klubeve sportive  5.2 Krijimi ambjenteve sportive për realizimin e stërvitjeve.  5.3 Përgatitja e trajnerëve.	MRKS Drejtoria e Sportit  MRKS Drejtoria e Sportit  MRKS-Drejt. Sportit	2004-ne vazhdim 2004-ne vazhdim 2004 - vazhdim	100 mijë  100 mijë 20 mijë
V	<b>Media</b>	6. Akses në mediat publike	6.1 Realizimi i programeve televizive dhe publikimeve në medianë dhe elektronike  6.2 Mbështetja e emisioneve dhe botimeve në periudhë në mbrojtje të të drejtave të këtij komuniteti, të propogandimit të vlerave të tij.  6.3 Organizimi i emisioneve për denoncimin e rasteve të diskriminimit dhe deformimit të imazhit të komunitetit Rom.	MKRS, KMB  MKRS, KMB  MKRS, KMB	2004-ne vazhdim 2004-ne vazhdim 2003-ne vazhdim	10 mijë  10 mijë  5 mijë

*Grupi Ministror i drejtuar nga zv. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale  
22 prill 2003*

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI III – EKONOMIA, PUNËSIMI, ULJA E VARFERISE DHE MBROJTJA SOCIALE**

N.r	Fushat	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto /Euro
I	<b>Tregu punës</b>	1. Inkurajimi dhe ndihme speciale në fusha të konsulences, studimit të tregut dhe mjetëve financiare për krijimin e bizneseve nga ana e komunitetit Rom	1.1 Evidentimi i bizneseve tradicionale Rome 1.2 Bashkëpunimi midis organizatave të biznesit Rome dhe organizatave financuese 1.3 Ndhime dhe konsulence në manaxhim	ME-ANVM Organizatave të biznesit Rome-ANVM Organizatave të biznesit Rome-ANVM	2004-vazhdim 2004-ne vazhdim 2004-ne vazhdim	10 mijë - 5 mijë/çdo vit
	<b>Punësimi dhe Formimi profesional</b>	2. Zbatimi i programeve speciale të nxitjes së punësimit për komunitetin Rom 3. Përdorimi politikave lehtësuese fiskale për ato kompani që punësojnë anetar të komunitetit Rom	2.1 Punësimi i Romëve nepërmjet programit të punëve publike. Fillimi i zbatimit të këtij programi (venia e fondeve në dispozicion nga Buxheti i shtetit për punet publike) 2.2 Përfshirja e Romëve të papunë në programet e nxitjes së punësimit. Punësimi i Romëve në programet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxitja e punësimit të punëkerkuesve të papunë</li> <li>• Nxitja e punësimit nepërmjet formimit në punë</li> <li>• Nxitja e punësimit nepërmjet formimit institucional</li> </ul> 3.1 Studim i mundësive të financimit për kompanitë ku punedhënes dhe punëmarres të jënë Rom 3.2 Studim për mundësitë e krijimit të lehtësirave fiskale për ato kompani që hapin vende pune për Romët. 3.3 Mbeshtëjtja me baze materiale, ambiente, mjete financiare dhe burime njerëzore për ato biznese që kanë si destinacion produktet e traditës së artizanatit.	SHKP  MPÇS, SHKP, MF  ME, MPÇS, MF  MF  ME, MPÇS, MF	2004 e ne vazhdim 2004 e ne vazhdim 2004 e ne vazhdim 2004 e ne vazhdim 2004 e ne vazhdim 2004 e ne vazhdim	36 mijë 2004 72 mijë / çdo vit  15 mijë / 2004 36 mijë / çdo vit  10 mijë  sipërfaqe të lira publike

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*  
**KAPITULLI III – EKONOMIA, PUNËSIMI, ULJA E VARFERISE DHE MBROJTJA SOCIALE**

N.r	Fushat	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto /Euro
		4. Integrimi i komunitetit Rom ne sistemin e arsimit dhe formimit profesional publik dhe privat.	<p>4.1 Identifikimi i profesioneve qe mund të mesohen nga Romët.</p> <p>4.2 Hapja e kurseve të formimit profesional për profesionet e identifikuar ne qendrat publike dhe private të formimit profesional</p> <p>4.3 Identifikimi i kontigjenteve Rome për punësimin e tyre si edukator kopshti parashkollor.</p> <p>4.4 Trainimi i kontigjentit të zgjedhur për profesionin edukator kopshti parashkollor</p> <p>4.5 Punësimi i tyre ne institucionet qe frekuentohen nga Romët</p> <p>4.6 Krijimi i kushtëve lehtësuese për formimin profesional të të papuneve Rome</p> <p>4.7 Hartimi i bazez ligjore qe stimulon apo lehtëson formimin profesional për Romët .</p> <p>5.1 Komunitat dhe bashkitë të evidentojne kerkesat për pune dhe profesione të komunitetit Rom</p> <p>5.2 Të analizoje jo me pak se dy here ne vit shkal-len e papunësisë se komunitetit Rom</p> <p>5.3 Financimi i projekteve të puneve publike të hartuara nga pushteti vendor ne lidhje me përmirësimin e infrastruktures se vendbanimeve të komunitetit Rom</p>	<p>MPÇS, SHKP ne bashkepunim me OJF Rome</p> <p>MPÇS-SHKP</p> <p>MPÇS, MASH, ne bashkepunim me OJF Rome</p> <p>MPÇS, MASH, OJF-të Rome</p> <p>MPÇS, MASH ne bashkepunim me OJF Rome</p> <p>MPÇS</p> <p>MPÇS</p> <p>MPVD</p> <p>MPVD</p> <p>MPVD</p>	<p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2003</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p>	<p>-</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>10 mijë</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>100 mijë</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>100 mijë / çdo vit</p>

*Strategjia Kombëtare*  
 "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"  
**KAPITULLI III – EKONOMIA, PUNËSIMI, ULJA E VARFERISE DHE MBROJTJA SOCIALE**

N.r	Fushat	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto /Euro
	<b>Mbrojtja sociale</b>	<p>1. Integrimi i fëmijëve Rom të rruges në jetën normale</p> <p>2. Asistencë për aplikimin e ndihmes ekonomike për familjet e varfëra</p> <p>3. Stimulimi dhe mbeshtetja e shoqatave të komunitetit Rom si përfaqesues të aspekteve të ndryshme të jetës së tyre</p>	<p>1.1 Ngritja e qëndrave ditore</p> <p>1.2 Bashkëpunimi me donatore vendas dhe të huaj, OJF që zbatojnë projekte në këtë fushë për të financuar procesin e edukimit dhe zhvillimit të kesaj kategorie fëmijësh.</p> <p>1.3 Kontrollë sistematike nga Inspektoriati Shtetëror i Punës lidhur me punën e zeze të fëmijëve Rome</p> <p>2.1 Organizimi i një fushate sensibilizimi në fushën e mbrojtjes sociale për të drejtën e përfimit për ndihmen ekonomike dhe pagesën e papunësisë, pagesë barrelingje dhe të drejta të tjera që lindin nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>2.2 Nxjerrja e një akti administrativ që obligon kumunat dhe bashkitë për t'u dhënë asistencë për plotësimin e dosjeve të familjeve Rome.</p> <p>3.1 Evidentimi dhe regjistrimi OJF-ve Rome</p> <p>3.2 Krijimi i rrjetit të OJF-ve</p> <p>3.3 Bashkëpunimi midis organeve të ndryshme vendimarrëse të shtetit dhe rrjetit të OJF-ve Rome</p> <p>8.4 Të krijohet një institut ose qender integrimi për komunitetin Rom.</p>	<p>MPÇS, SHSSH</p> <p>MPÇS, SHSSH</p> <p>MPÇS, ISHP</p> <p>MPÇS, ISHP, MPVD</p> <p>MPVD</p> <p>MPÇS</p> <p>OJF-të Rome</p> <p>MPÇS, OJF Rome</p> <p>Keshilli i Ministrave</p>	<p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2003-vazhdim</p> <p>2003-04-08</p> <p>2003-vazhdim</p> <p>2004</p>	<p>10 mijë / çdo vit</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>3 mijë</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>10 mijë</p> <p>-</p> <p>Buxheti Shtetit</p>

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*  
**KAPITULLI III – EKONOMIA, PUNËSIMI, ULJA E VARFERISE DHE MBROJTJA SOCIALE**

N.r	Fushat	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto /Euro
	<b>Kushtet e punës</b>	1. Marrja e masave për eliminimin e rasteve abuzive të shkeljeve të dispozitave të Legjislacionit të Punës nga punedhënesit (kushtet e punës, pagat, orari i punës etj.)	1.1 Forcimi i kontrollit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës ne subjektet qe kane të punësuar Rom. 1.2 Informimi për Legjislacionin e Punës.	MPÇS, ISHP  ISHP	2003 e ne vazhdim  2003 e ne vazhdim	-  10 mijë / çdo vit
	<b>Sigurimet shoqerore</b>	1. Përfshirja e popullise aktive Rome ne skemen e detyrueshme të sigurimeve shoqerore, ne kushtet qe nje pjese e mire e Romëve merren me aktivite joformale.	1.1 Dhenia e informacionit të mjaftueshem për skemen e sigurimeve shoqerore nepërmjet mjeteve të informimit publik. 1.2 Bashkepuniimi me Inspektoriatin Shtetëror të Punës për kontrollin e veprimtarive joformale, me qellim tërheqjen ne skeme të Romëve qe punojne ne sektorin privat.	ISSH  ISSH, ISHP	Ne vijimesi  Ne vijimesi	10 mijë/çdo vit  -
	<b>Gjendja Civile</b>	Regjistrimi i popullise Rome ne zyrat e gjëndjes civile	1.1 Të hartohet programi përkatës i rregjistrimit 1.2 Të sigurohen mjetet e nevojshme njerezore, monetare dhe materiale	MPVD dhe OJF Rome  MPVD, MF	2004  2004-2005	50 mijë  Buxheti Shtetit

*Grupi Ministror i drejtuar nga z.v. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale*  
22 prill 2003

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*

**KAPITULLI IV – SHENDETËSIA DHE INFRASTRUKTURA**

Nr	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
	<b>Shendetësi</b>	1. Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijes	<p>1.1 Zbatimi i vaksinimit të detyrueshem për të gjithë fëmijët 0-14 vjeç</p> <p>1.2 Futje e programeve promovuese dhe edukativo-shendetësore për shëndetin riprodhues në komunitetin Rom</p> <p>1.3 Ndergjegjesimi i komunitetit Rom për përdorimin e metodave moderne të Planifikimit Familjar (Rritja e përdorimit të metodave kontrceptive)</p> <p>1.4 Rritja e kujdesit për gruan shtatzane dhe fëmijën e porsalinjdur</p>	<p>MSH e DSHP- të e rretheve</p> <p>MSH / ISHP dhe DSHP- të e rretheve</p> <p>MSH /OJF</p> <p>MSH dhe DSHP- të e rretheve</p>	<p>2003 e ne vazhdim</p> <p>2005-2006</p> <p>2005 - 2010</p> <p>2004 e ne vazhdim</p> <p>2004 - 2006</p> <p>2005-2010</p> <p>2005 -vazhdim</p>	<p>Buxheti i shtetit 10 mijë</p> <p>200 mijë</p> <p>Buxheti i shtetit</p> <p>-</p> <p>-</p> <p>100 mijë</p> <p>50 mijë cdo vit</p>
		2. Asistence me medikamente dhe ndihma të tjera mjekësore për familjet me shumë fëmijë dhe të varfëra.	<p>2.1 Evidentimi i familjeve të varfëra dhe me shumë fëmijë</p> <p>2.2 Rritja e aksesit për shërbim shëndetësor përmirësimi të struktures shëndetësore (ndërtim të qendres shëndetësore dhe ambulancave sipas shtrirjes së komunitetit Rom dhe rregullave ne fuqi)</p> <p>2.3 Trajtim medikamentoz falas në rastet e semundjeve në familjet e varfëra Rome</p>	<p>DSHP, PV</p> <p>MSH, PV</p> <p>MSH, PV</p>		

Strategjia Kombëtare  
"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"

KAPITULLI IV – SHENDETËSIA DHE INFRASTRUKTURA

Nr	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
		3. Vlerësimi i morbozitetit dhe mortalitetit në komunitetin Rom dhe masat për eliminimin e tyre	3.1 Evidentimi i semundjeve dhe shkaqeve të vdekjeve dhe vlerësimi krahasues me pjesen tjetër jo Rom 3.2 Përmirësimi i kushteve mjedisore si uji i pijshëm, higjiena e mjedisit dhe infrastruktura tjetër e zonave të banimit të komunitetit Rom	MSH / DSHP-të e rretheve MSH dhe Pushteti Vendor	2005 - 2010 2005 - 2015	Buxheti i shtetit
	<b>Kushtet e banimit</b>	4. Sigurimi i nevojave minimale për strehim	4.1 Identifikimi i nevojave për strehim duke u nisur nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Numri familjeve</li> <li>➤ Numri pjesetareve për një familje</li> <li>➤ Kushtet aktuale të banimit</li> </ul> 4.2 Evidentimi i banesave që kanë nevojë për t'u riparuar dhe hartimi i projektit. 4.3 Identifikimi i pronësisë mbi truallin në të cilën është vendosur kjo pjesë e komunitetit 4.4 Llogaritja e nevojave për truall dhe materiale ndërtimi duke stimuluar ndërtimin e banesave nga vetë komuniteti. 4.5 Ndërtimi i banesave të thjeshta për banorët pa strehim dhe me kushtë të pabanueshme	MRTT, PV, OJF Rome MRTT, PV, OJF Rome MRTT, PV, ZRPP, OJF Rome MRTT, PV, OJF Rome MRTT	2003-2005 2004-2005 2004-2005 2004-2007 2004-2010	200 mijë Buxheti Shtetit dhe donatore

Grupi Ministror i drejtuar nga z.v. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale  
22 prill 2003



*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*  
**KAPITULLI IV – SHENDETËSIA DHE INFRASTRUKTURA**

Nr	Fusha	Objektivat	Masat prioritare	Struktura përgjegjëse	Koha e realizimit	Kosto / Euro
		5. Mbulimi me rrjetin ujeshelles kanalizim dhe energjine elektrike ne gjithë komunitetin Rom	<p>5.1 Llogaritja e nevojave për ujeshelles, rrjeti elektrik dhe telefonik, kanalizime të komunitetit</p> <p>5.2 Nxitja e komunitetit për të kontribuar ne nderimin e infrastruktures</p> <p>5.3 Lidhja e rrjetit kryesor me rrjetin e brendshem nepërmjet investimit nga shteti dhe donatore të huaj.</p> <p>5.4 Sigurimi i pajisjeve për përmirësimin e kushteve të brendshme higjieno-sanitare</p> <p>5.5 Sigurimi i kabinave të nevojeshme për mbulimin me energji elektrike të zones ku jëton komuniteti Rom.</p>	<p>MRTT, OJF-të Rom edhe Pushteti Vendor</p> <p>MRTT, MPCPS, MF, OJF-të Rome dhe Pushteti Vendore</p> <p>MRTT, MPCPS, MF, OJF-të Rome dhe Pushteti Vendore</p> <p>MRTT, MPCPS, MF, OJF-të Rome dhe Pushteti Vendor</p> <p>KESH, MF, O.Q.V. dhe Pushteti Vendor</p>	<p>2003-2005</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-ne vazhdim</p> <p>2004-2006</p> <p>2004-ne vazhdim</p>	<p>Buxheti Shtetit dhe donatore</p>
	<b>Rrjeti i brendshem rrugor</b>	6. Sigurimi i lidhjeve të vendbanimeve me rrugen nacionale	<p>6.1 Kryerja e studimit dhe hartimi i projektit</p> <p>6.2 Ndertimi i rrugeve</p> <p>6.3 Mobilizimi i komunitetit</p>	<p>OQV, MRRTT, MPCPS komuniteti Rom, MF</p>	<p>2003-2004</p> <p>2004-2007</p> <p>Ne vazhdimesi</p>	<p>200 mijë</p> <p>Buxheti Shtetit dhe Donatore</p>

*Grupi Ministror i drejtuar nga zv. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale*  
 22 prill 2003

*Strategjia Kombëtare*  
*"Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom"*  
**KAPITULLI V – RENDI PUBLIK, DREJTËSIA, ADMINISTRATA CIVILE**

Nr.	Fusha	Objektivat	Masat prioritetë	Struktura përgjegjëse	Koha realizimit	Kosto/ USA
1.	<b>Rendi</b>	1. Evidentimi i llojeve të krimin tek Komuniteti Rom dhe masat për uljen e tyre	1.1 Evidentimi dhe lufta për : <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ parandalimin e trafikimit të femijëve dhe vajzave Rom .</li> <li>➤ parandalimi i krimeve ordinere</li> </ul> 1.2 Marrja e masave efektive për parandalimin e kerçenimit të Romëve për qellime abuzive nga individë të vecantë të policisë. 1.3 Studimi i rasteve të moszbatimit korrekt të ligjit gjatë nderhyrjeve dhe kontrolleve të Komunitetit Rom dhe parandalimi i ketyre fenomeneve ne të ardhmen. 1.4 Të rritët bashkepuniimi policise me shoqatat përfaqesuese të Komunitetit Rom me synim parandalimin e krimit, trafiqeve, dhunes ne familje si dhe abuzimeve nga punonjesit e policise. 1.5 Rritja e komunikimit Polici - Komuniteti Rom.	MRP  MRP  MRP  MRP- OJF-të Rom e  MRP	2003 - 2005.	35 mijë
2.	<b>Policia</b>	2. Përfshirja e anetareve të komunitetit Rome ne efektivat e policise ne ato qarqe ku ato kane komunitet	2.1 Krijimi i hapsirave dhe ndihme për të rinjtë Rom për të marre pjese ne proceset e konkurimit ne Akademine e Policise. 2.2 Trajnimi i të rinjve Rom me synim punësimin e tyre si efektiv policie. 2.3 Përcaktimi i kuotave vjetore për të shkolluar të rinj Rom ne Akademine e Rendit.	MRP  MRP  MRP	2003 - 2005	-  -  -
3	<b>Trafikimi dhe pjesëmarrja</b>	3. Parandalimi dhe goditja e rasteve të trafikimit të qenieve njerezore, pjese e Komunitetit Rom dhe sidomos e trafikimit të femijëve dhe vajzave për qellim shfrytëzimi	2.1 Identifikimi i rasteve të trafikura 2.2 Parandalimi dhe marrja e masave për femijët dhe vajzat e trafikuar. 2.3 Hartimi i nje programi të vecantë për të luftuar fenomenin e trafikimit të femijëve dhe grave të Komunitetit Rom.	MRP, MJ, ne bashkepuniimin me organizata nderkombetare si UNHCR e cila ka filluar ngritjen e qendrave, M.P.Ç.S	2003 e ne vazhdim.	35 mijë

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom = National strategy for improving Roma living conditions / OSBE. - Tiranë : OSBE, 2006

84 f. 29 cm

ISBN 99927-972-9-0

316.43(=214.58:496.5)

323.15(=214.58:496.5)

342.724(496.5)